LEXMARK LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Çështje azili
- Apelime kundër dëbimit

*Ne ju mbështesim me përkushtim dhe transparencë në çdo fazë të procesit.*

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.

The Law Society

THAMES VALLEY CHAMBER OF COMMERCE GROUP

Legal awards 2021

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239 High Road, Wood Green, London N22 8HF

www.lexmarklegal.com

The Albanian

VITI I 24 I BOTIMIT 10 KORRIK 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

# KUSH GUXON TË FLASË PËR AEROPORTIN E KUKËSIT?



PETRIT KUÇANA

## KUSH I NGRIU "FLATRAT E VERIUT"






ARBEN MANAJ

## BRITANIA NIS STËRVITJEN "OPERATION ALBISTON SHADOW", USHTRIA PËRGATITET PËR RASTET SULMESH HIBRIDE

### LETËR E HAPUR NJERËZVE TË DREJTËSISË: SHTET I SË DREJTËS APO BANDË E MADHE PLAÇKITËSISH

FATOS LUBONJA



### SHTATË ARGUMENTE KUNDËR SHITJES SË TOKËS SË HUAJVE

ARTAN FUGA



### EKONOMIA E QELESHES DHE EKONOMISTËT E POTUREVE

SONILA MEÇO



### ATA QË E KAPIN DITËN DHE ATA QË E SHESIN BREGDETIN!

KIM MEHMETI



### DY MINISTRA TË SERBISË DHE ANALOGJIA QË EVROPA SHMANG

VETON SURROI






Rashid A.Khan Solicitor (Principal)Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON , LONDON SW19 1AX

RASHID and RASHID LAW FIRM

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

The Albanian newspaper in London
THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk
albania7@gmail.com
Tel: 020 7018 7929

# KUSH GUXON TË FLASË PËR AEROPORTIN E KUKËSIT?



**PETRIT KUÇANA**

As që mund mendohet se do të gjendet lehtë, jo faji por shakaku i kyçjes së aeroportit të Kukësit.

Në këto ditë përvëluese, kur mërgata është nisur për të kaluar pushimet në mëmëdhe, pikërisht në këtë kohë, ai që u trumpetua si sukses i padiskutueshëm i qeverisë shqiptare, Aeroporti i Kukësit, i është vënë kyçi.

**Flatrat e Veriut janë ngrirë...**
E gjithçka mbulohet me tisin e heshtjes, sikur asgjë të mos ketë ndodhur, sikur ashtu padashje u bë gabim që u hap, aeroporti i qarkut më të varfër të republikës.

'Flatrat e Veriut' janë ngrirë dhe si një makth që pret përfundojë, e lënë andej, pa ndonjë vëmendje, pa ndonjë interses, (si fëmijë të gjetur), por kurrësesi si mundësi për të gjithë qarqet e veriut dhe jo vetëm.

Ngjan kaq e thjeshtë pyetja përse, apo kërkesa për ndonjë sqarim, jo vetëm për votuesit e bindur të paimunizuar me propagandën gjithëpërfshirëse qeveritare, por për qytetarët e thjeshtë, qoftë edhe për turistët.

Askush nuk guxon, jo të japë përgjigje, por as të përmendë se ka qenë, se ka ekzistuar një aeroporti i tillë, se u bë kaq shumë propagandë s vetë 'i madhi', shkoi atje, si mesia, shpëtimtari që do të sillte siç tha në atë kohë. 'çunat e Londrës' në Kukës.




Po vetëm pak kohë më pas, po ngjan se diçka ka shkuar keq, se ca llogari janë bërë gabim dhe se zgjidhja paskërka qenë, venia e kyçit aeroportit të vetëm alternativ të vendit.

**'Flatrat e Veriut' i ngrinë në këtë vapë përvëluese, duke kërkuar më çdo kusht mbulimin e padepërtueshëm më tisin e heshtjes.**

Askush nuk goxon që të pyesë qoftë edhe për një përgjigje të thjeshtë, të pafajshme, konkrete, që të mund të lehtësojnë peshën e pyetjes 'përse'. Shumëkush mund të justifikohet me shprehjen e famshme të kryeministrit të Kosovës Albin Kurti, për 'Shqipërinë e Kastratit dhe jo të Kastriotit'.

Të tjerët besojnë se do të duhej me patjetër që aeroporti i Kukësit, të ishte një motor i vërtetë zhvillimi jo vetëm për qarqet e veriut, më të varfërat në vend, por motor i fuqishëm për zhvillimin e tuurizmit në vend.

***Kur më shumë se tani është dashur ai aeroport?***

***A do të guxojë kush, qoftë shtetar apo pastronazhist që të sqarojë psenë?***

Gjasat janë se tisi i heshtjes, do të vazhdojë të mbulojë 'Flatrat e Veriut' edhe për shumë e shumë kohë, ndërkohë që edhe një tra tjetër është vënë mbi qafën e banorëve më të varfër të republikës…

***ribotim***



LEXMARK
LEGAL

# DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

*Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.*

*Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.*



## SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apelime dhe rishikime vizash

*Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.*

**Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.**
**Ekspertë të besuar të imigracionit.**

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

# ANDY BURNHAM HAP 'NO10 NORTH' NË MANÇESTER, NJË ZYRË E RE QEVERITARE JASHTË LONDRËS




Andy Burnham ka thënë se hapja e zyrës së re qeveritare "No10 North" në Mançester ishte "dita më e mirë e jetës së tij". Kjo zyrë synon të jetë një qendër veriore e qeverisë britanike, duke zhvendosur një pjesë të pushtetit larg Londrës dhe Westminster-it.

Burnham, i cili më parë ka qenë kryebashkiak i Greater Manchester, tha se momenti kishte një rëndësi personale për të, sepse lidhej me kthimin e tij në qytetin ku kishte nisur karrierën pas universitetit.

Ai e përshkroi No10 North si një mënyrë për të sjellë vendimmarrjen më afër rajoneve të veriut të Anglisë dhe për të forcuar decentralizimin. Ai kundërshtoi kritikët që e quajnë projektin thjesht një "shfaqje simbolike", duke thënë se zyra do të përdoret për punë reale qeveritare.

Artikulli përmend gjithashtu se Burnham kishte udhëtuar me avion qeveritar drejt Mançesterit pas një angazhimi në Glasgow, gjë që ka shkaktuar disa kritika për kostot dhe ndikimin mjedisor.

Në të njëjtën kohë, qeveria e tij ka njoftuar masa ekonomike si heqja e TVSH-së për faturat e energjisë elektrike, kufizimi i çmimeve të autobusëve dhe lehtësime për bizneset e vogla, megjithëse kundërshtarët kanë ngritur pyetje për mënyrën e financimit të tyre.

## Qeveria e Burnham heq TVSH-në nga faturat e energjisë elektrike, familjet kursejnë rreth 45 paund në vit

Në ditën e parë të punës si kryeministër, Andy Burnham ka bërë njoftimin e tij të parë të madh politik: qeveria e tij do të heqë TVSH-në nga faturat e energjisë elektrike për familjet.

Sipas planit, norma e TVSH-së për energjinë elektrike do të ulet nga 5% në 0% duke filluar nga tetori. Qeveria thotë se kjo do t'i kursejë një familjeje mesatare rreth 45 paund në vit.

Burnham deklaroi se kostoja e kësaj mase do të mbulohet duke anuluar skemën e kartës së identitetit digjital të propozuar nga qeveria e mëparshme e Keir Starmer.

Megjithatë, Darren Jones, ish-sekretar kryesor i Thesarit në qeverinë e Starmerit, kritikoi vendimin duke thënë se skema e identitetit digjital ishte "e pafinancuar" dhe kërkoi që qeveria e re të tregojë në buxhet se nga do të vijnë paratë për politikat e reja.

Ministri i Biznesit, Jonathan Reynolds, u pyet nga BBC nëse ishin gjetur kursimet për të financuar këtë vendim. Ai tha se ato "duhej të ishin gjetur" dhe e përshkroi vendimin si një zgjedhje të ligjshme politike.

Pas marrjes së postit të kryeministrit, Burnham prezantoi edhe kabinetin e tij të ri:

John Healey u emërua kancelar i Thesarit,
Ed Miliband mori postin e sekretarit të Jashtëm,
Wes Streeting u bë ministër i Mbrojtjes.
Ndërkohë, Angela Rayner u rikthye në detyrën e ministres së Strehimit, ndërsa Shabana Mahmood vazhdoi si ministre e Brendshme.

Ky ishte fillimi i mandatit të ri të Burnhamit, me fokus te ulja e kostove për familjet dhe ndryshimet në politikat e qeverisë.

## Andy Burnham ul çmimin e autobusëve në Angli: Biletat do të kushtojnë 2 £

Kryeministri i ri i Britanisë së Madhe, Andy Burnham, ka njoftuar se çmimi maksimal i një udhëtimi me autobus në gjithë Anglinë do të jetë 2 £ nga viti i ardhshëm.

Masa është pjesë e një pakete për uljen e kostos së jetesës dhe synon t'u japë qytetarëve më shumë lehtësim financiar.

Burnham, i cili më parë si kryetar i Bashkisë së Mançesterit vendosi kufirin prej 2 £ për një biletë të vetme në rrjetin Bee Network, tha se qeveria e tij do të fokusohet në ndihmën për familjet që po përballen me shpenzime të larta.

Kufiri prej 2 £ për autobusët në nivel kombëtar ishte vendosur fillimisht nga qeveria konservatore në vitin 2023, por u rrit në 3 £ në vitin 2024.

Përveç uljes së tarifave të autobusëve, Burnham ka premtuar edhe masa të tjera:

⚡ Heqjen e TVSH-së nga faturat e energjisë elektrike nga tetori, që sipas llogaritjeve mund t'u kursejë familjeve rreth 45 £ në vit.
⚡ [illegible]etn 4 politikë më të gjerë për të ulur presionin financiar mbi qytetarët.
Burnham pranoi se këto masa "nuk do të zgjidhin gjithçka", por tha se janë një hap i parë për të ndihmuar njerëzit me koston e jetesës.

## Këshilli i Lewisham kufizon bashkëpunimin me Home Office për kontrollet e emigracionit

Këshilli i Lewisham në Londrën e Jugut ka miratuar një mocion që synon të kufizojë ndihmën që autoriteti lokal i jep Home Office-it gjatë operacioneve të kontrollit të emigracionit.

Vendimi, i propozuar nga administrata e Gjelbër e këshillit, parashikon që Lewisham të mos përdorë burimet dhe shërbimet e veta për të ndihmuar bastisjet e emigracionit, përveç rasteve kur ligji e kërkon një gjë të tillë.

Mbështetësit e vendimit thonë se masa ka për qëllim të mbrojë komunitetet e emigrantëve dhe njerëzit në situata të vështira, duke siguruar që banorët të mos kenë frikë të kërkojnë ndihmë nga shërbimet lokale.

Sipas tyre, njerëzit duhet të ndihen të sigurt për të kërkuar mbështetje për çështje si strehimi, shëndeti apo problemet familjare, pa frikën se informacioni i tyre mund të përdoret për qëllime emigracioni.

Kundërshtarët e vendimit argumentojnë se zbatimi i ligjeve të emigracionit është përgjegjësi e qeverisë britanike dhe se autoritetet lokale duhet të bashkëpunojnë me Home Office kur kërkohet.

Lewisham është bërë një nga këshillat e para në Britani që merr një qëndrim të tillë ndaj operacioneve të emigracionit. Vendimi nuk ndryshon ligjet e emigracionit dhe nuk u jep emigrantëve status të ri ligjor, por tregon një qasje më mbështetëse ndaj komuniteteve të emigrantëve në nivel lokal.



Dotech
Websites

SHQIPTARË NË BRITANI

# BIZNESI JUAJ MERITON NJË WEBSITE MODERNE

Tërhiq më shumë klientë.
Rrit biznesin tuaj në Britani.

**DESIGN MODERN**
Website profesionale, të bukura dhe unike.

**OPTIMIZUAR PËR GOOGLE (SEO)**
Më shumë vizitorë, më shumë klientë.

**I PËRSHTATUR PËR ÇDO PAJISJE**
Perfekt në telefon, tablet dhe kompjuter.

**EMAIL PROFESIONAL ME EMRIN TUAJ**
Dukeni më profesionist dhe më të besueshëm.

**DYQAN ONLINE (E-COMMERCE)**
Shisni produktet tuaja online.

**MBËSHTETJE NË SHQIP**
Ne jemi këtu për ju, kurdo që na nevojitet.




## PËR ÇDO LLOJ BIZNESI

NDËRTUES | TAKSI | RESTAURANTE | PARUKERI & ESTETIKË | DYQANE | AVOKATË | AGJENCI PRONASH | DHE SHUMË TË TJERA

## NA KONTAKTONI SOT PËR NJË KONSULTIM FALAS!

*Flasim shqip, ju kuptojmë!*

020 7018 7929
073 4066 5946
info@dotech.uk
www.dotech.uk



NË TË GJITHË BRITANINË
- London
- Manchester
- Birmingham
- Leicester
- Dhe më shumë...

TË SIGURTA 100% | TË SHPEJTA MAKSIMALE | REZULTATE TË MATSHME | MBËSHTETJE E VAZHDUESHME

DOTECH WEBSITES – PARTNERI JUAJ PËR SUKSESIN ONLINE!

# "DO VRAS NIGEL FARAGE"! ARRESOHET KËRCËNUESI NË BRITANI

**ARBEN MANAJ**

Policia ka arrestuar një person që ka kërcenuar në mediat sociale se do të qëlloj në kokë dhe vrasë, udheheqësin e partisë "Reforma", Nigel Farage, parti në opozitë në Britani, e cila në sondazhet e opinionit publik gjatë tërë vitit ka qënë mbi partinë Laburiste në pushtet të kryeministrit në ikje Sir Kier Starmer.

I dyshuari e cilëson veten si terrorist në postimet e tij në mediat sociale, dhe në një prej tyre ka paralajmëruar Nigel Farage, se "Unë do të qëlloj ëe kokë nëse ti fiton", sipas Telegraph të Londrës.

Ky lajm vjen në një kontekst të ngarkur, kur një javë më parë u vra si objektiv i targetuar ish-Ministrja e Brendshme britanike në kohën e konservatorëve që drejtuan Britaninë për 15 vjet para fitores së Laburistëve në 2024, Ann Widdecombe, e cila së fundmi ishte zëdhënësja për çështjet e Ligjit dhe Drejtësisë e Partisë Refoma të Nigel Farage, e njohur për narrativën populiste dhe anti-emigracion.

Po sot, para daljes së lajmit të arrestimit të të dyshuarit, një drejtues i lartë i kësaj partie dekrloaj se nese parti Reforma vjen në pushtetë, ajo do ofroje mbrojtjen e përshatshme 24 ore si për deputetet aktual ashtu edhe ish deputetët britanik, pa specifikuar shifrën monetare të një operacioni të tillë policor.

Në fakt, si kjo parti ashtu edhe Laburistët dhe tërë deputetët britanik në parlament, kanë kërkuar një mbrojtje më të mirë për politikanët.

Në vitet e fundit dy deputetë britanik janë vrarë, konkretisht Sir David Amess dhe Jo Cox,



ndërkohë Ann Widdecombe, 78 vjecare u bë treta ish-deputete javën e kaluar ose deputet që vritet, ndërkohë Nigel Farage ankohet se policia nuk ka bërë asgjë për të luftuar kërcënimet online dhe dhunën në botën reale.



# FOR SALE

## UNISEX SALON

ST. JOHN'S WOOD
NW8




## BERBER PËR SHITJE
## 15 VJET KONTRATË

**I HAPUR PREJ VITESH**
Biznes i konsoliduar me klientelë të rregullt.

**ME KLIENTELË TË GARANTUAR**
Klientë besnikë dhe fluks i qëndrueshëm.

**MUNDËSI FANTASTIKE**
Për zhvillimin e biznesit, apo për ta kthyer në kafe, rrobaqepsi apo biznes tjetër.

SALLONI NDODHET
NË NJË NGA ZONAT
MË TË FREKUENTARA
TË ST. JOHN'S WOOD NW8

ÇMIMI I ARSYESHEM







MOS E HUMBNI
KËTË MUNDËSI BIZNESI
NA KONTAKTONI:

**07453 909190**

# BRITANIA NIS STËRVITJEN/ "OPERATION ALBISTON SHADOW", USHTRIA PËRGATITET PËR RASTET SULMESH HIBRIDE

**ARBEN MANAJ**

Të cilësuara "Operation Albiston Shadow", kryeministria thotë se në këto manovra ushtarake dhe jo vetëm do të përfshihen ministrat, si dhe qindra zyrtarë në qeveri dhe administratën publike, ku do të testohen kundërpërgjigjet në rastin e sulmeve hibride në kuadër të një lufte konvencionale.

Se çfarë kërcënimesh konkretisht do të simulohen në këtë skenar nuk përmenden, por me shumë gjasa do të ketë sulme kibernetike, akte sabotazhi dhe vrasje politike. Manovrat më të mëdha pas shumë dekadash do të vazhdojnë për disa ditë dhe do të kompletohen me manovra më të mëdha në kuadër të NATO-s, të koduara CMX27, dhe pritet të zhvillohen vitin e ardhshëm, pa deklaruar se kur saktësisht.



Për herë të parë, rreziku nga ndërhyrjet në procesin demokratik në Britani do të jetë pjesë e manovrave për të parë sa e përgatitur është Britania për t'i zbrapsur këto ndërhyrje, kur për herë të parë mes gjashtë rreziqeve përfshihet edhe potenciali për lehtësimin nga inteligjenca artificiale të sulmeve më të sofistikuara kibernetike ndaj të dhënave të infrastrukturës, asaj të ujit, si dhe në sistemet politike. Këto manovra zhvillohen ndërkohë që rriten shqetësimet për një sulm rus ndaj një vendi të NATO-s, pasi ushtria ruse në mënyrë të rregullt shkel hapësirën ajrore të vendeve të Aleancës. (Sipas Darren Jones, Sekretarit të Përgjithshëm pranë kryeministrit Starmer, duke folur në Parlament, do të ketë edhe një fushatë sensibilizuese për vendosmërinë e publikut për të përballuar situatat e luftës.)

Qëllimi do të jetë që të ndihmohen britanikët e thjeshtë të kuptojnë masat e thjeshta që mund të ndërmarrin përpara çrregullimeve potenciale në rast sulmi. Mes rreziqeve janë sulmet kibernetike që mund të shkaktojnë ndërprerje masive të energjisë elektrike, të furnizimit me ujë të popullsisë, sinjaleve telefonike apo aksesin tek marketet ushqimore lokale. Ndërkohë do të ketë udhëzime për shkollat dhe kolegjet se si të mësohen fëmijët të qëndrojnë në vende të sigurta gjatë rasteve të emergjencave dhe në kohë lufte. (Në dokumentet zyrtare të mbrojtjes në Britani, në rast të një lufte bërthamore, këshillimet mbeten sekrete dhe nuk përfshihen në regjistrin e publikuar të përditësuar nga autoritetet së fundmi, por besohet se janë masa që tashmë adoptohen edhe në vende të tjera evropiane.)

Media britanike zbuloi para dy vjetësh se Britania nuk kishte një plan të mbrojtjes kombëtare dhe Libri i Luftës i qeverisë ishte në sirtar që nga koha kur përfundoi Lufta e Ftohtë.

# BURNHAM PEZULLON SKEMËN PËR LIRIMIN E PARAKOHSHËM TË TË BURGOSURVE NË ANGLI DHE UELLS

Andy Burnham ka njoftuar pezullimin e skemës që do t'u mundësonte mijëra të burgosurve në Angli dhe Uells të liroheshin më herët nga burgu.

Vendimi erdhi pas kritikave të forta nga të mbijetuarit e krimeve dhe familjet e viktimave, përfshirë Lissie Harper, e veja e oficerit të policisë Andrew Harper, e cila e cilësoi mundësinë e lirimit të hershëm të vrasësve të bashkëshortit të saj si "të papranueshme".

Skema, e parashikuar të hynte në fuqi në shtator përmes Aktit të Dënimeve (Sentencing Act), synonte të ulte mbipopullimin në burgje. Sipas saj, disa të dënuar do të mund të liroheshin pasi të kishin vuajtur vetëm një të tretën e dënimit, në vend të gjysmës, ndërsa pjesën e mbetur të dënimit do ta kalonin në komunitet nën mbikëqyrje. Për të dënuarit për vepra më të rënda, lirimi do të bëhej pas vuajtjes së gjysmës së dënimit, në vend të dy të tretave.



Sekretari i ri i Drejtësisë, Alex Norris, tha se pezullimi i skemës synon t'u japë "siguri viktimave dhe të mbijetuarve", duke shtuar se qeveria dëshiron të sigurohet që zbatimi i politikës të bëhet në mënyrën e duhur. Ai njoftoi gjithashtu një rishikim të procedurave të informimit të viktimave dhe familjeve të tyre lidhur me lirimet e parakohshme.

Burnham deklaroi se "asnjë i burgosur nuk do të lirohet sipas kësaj politike derisa të përfundojë një rishikim urgjent dhe të bëhet gjithçka e mundur për të minimizuar rrezikun për publikun", duke shtuar se, nëse do të nevojiten ndryshime, ato do të zbatohen pa hezitim.

Sipas BBC-së, rreth 700 të burgosur pritej të përfitonin nga skema në fillim të muajit shtator.

Vendimi për pezullimin e saj u ndikua edhe nga reagimet e familjes së oficerit Andrew Harper, i cili u vra në vitin 2019 pasi u tërhoq zvarrë nga një automjet i drejtuar nga tre adoleshentë. Dy prej autorëve të dënuar me nga 13 vjet burg do të kishin të drejtë të përfitonin nga skema duke filluar nga qershori i vitit 2027.

Lissie Harper kritikoi ashpër planin, duke thënë se politikanët po marrin vendime "nga pas tavolinave", pa menduar për pasojat që ato kanë për familjet e viktimave. Edhe nëna e Andrew Harper u shpreh se djali i saj nuk kishte marrë drejtësinë që meritonte dhe se shumë familje të tjera ndajnë të njëjtin shqetësim.

Në javët e fundit, mijëra viktima dhe familjarë të tyre kishin marrë letra zyrtare që i njoftonin se skema e lirimit të parakohshëm do të hynte në fuqi në shtator, përpara se qeveria të vendoste pezullimin e saj.

# VARKA E POLICISË GODET URËN WESTMINSTER, PESË OFICERË TË PLAGOSUR

Pesë efektivë të Policisë Metropolitane të Londrës kanë mbetur të lënduar pasi një varkë policie u përplas me urën Westminster, në qendër të kryeqytetit britanik.

Sipas policisë, incidenti ndodhi rreth orës 15:40 sipas orës lokale dhe përfshiu një varkë të Njësisë së Policisë Detare. Në bord ndodheshin edhe efektivë të armatosur.

Policia Metropolitane bëri të ditur se disa nga efektivët ranë në ujë pas përplasjes, por u nxorën nga lumi. Autoritetet janë në pritje të vlerësimit të plotë për shkallën e dëmtimeve të tyre.

Nuk raportohet për persona nga publiku të përfshirë apo të lënduar në aksident.

Efektivët e nxjerrë nga lumi u panë duke marrë ndihmë mjekësore nga paramedikët në një varkë të zezë pranë bregut të lumit.

Zona rreth urës Westminster është rrethuar nga policia, ndërsa në vendngjarje kanë mbërritur një numër i madh forcash policie, zjarrfikësish dhe ambulancash. Ura, e cila kalon mbi lumin Tamiz pranë Parlamentit britanik, u mbyll përkohësisht dhe autobusët e mjetet e transportit u detyruan të kthehesin pas dhe të përdornin rrugë alternative.

# A KISHTE MOTIV POLITIK PAS SULMIT NDAJ ISH DEPUTETES BRITANIKE? DOKUMENTE PËR FARAGE NË SHTËPINË E TË DYSHUARIT

Hetimi për vrasjen e ish-deputetes britanike Ann Widdecombe ka marrë një kthesë të re pasi në shtëpinë e të dyshuarit Joshua Kerry janë gjetur materiale dhe artikuj gazetash që lidhen me Nigel Farage dhe partinë Reform UK.
Zbulimi ka bërë që policia kundër terrorizmit të shqyrtojë nëse mund të ketë pasur një motiv politik pas sulmit.

Widdecombe, ish-ministre konservatore dhe zëdhënëse e Reform UK, ishte një mbështetëse e njohur e Farage dhe kishte dalë publikisht në mbrojtje të tij pak para vdekjes së saj. Tani hetuesit po përpiqen të kuptojnë nëse materialet politike të gjetura në shtëpinë e të dyshuarit tregojnë një obsesion, kundërshtim ekstrem ose ndonjë motiv ideologjik.



Megjithatë, deri tani nuk ka prova publike që Nigel Farage apo Reform UK kanë ndonjë përgjegjësi në këtë ngjarje. Autoritetet po hetojnë vetëm nëse bindjet politike ose konfliktet ideologjike mund të kenë luajtur rol në motivin e të dyshuarit.

Dotech
Websites

SHQIPTARË
NË BRITANI

# BIZNESI JUAJ MERITON NJË WEBSITE QË SJELL REZULTATE!

Krijojmë faqe interneti moderne, të shpejta dhe të optimizuara për Google, që i ndihmojnë bizneset shqiptare në Britani të **rriten** dhe të fitojnë **më shumë klientë**.

- WEBSITE PROFESIONALE DHE MODERNE
- DYQAN ONLINE (E-COMMERCE)
- I PËRSHTATUR PËR TELEFON, TABLET DHE KOMPJUTER
- EMAIL PROFESIONAL ME EMRIN E BIZNESIT TUAJ
- OPTIMIZIM PËR GOOGLE (SEO)
- MBËSHTETJE TEKNIKE NË GJUHËN SHQIPE
- SHPEJTËSI DHE SIGURI MAKSIMALE




## PËR ÇDO LLOJ BIZNESI:

NDËRTUES · TAKSIST · RESTAURANT · PARUKERI / ESTETIKE · DYQAN · AVOKAT · AGJENCI PRONASH · DHE ÇDO LLOJ BIZNESI TJETËR

Ne krijojmë një faqe interneti që ju ndihmon të fitoni <u>më shumë</u> klientë dhe të <u>rrisni besueshmërinë</u> e biznesit tuaj.

## NA KONTAKTONI SOT PËR NJË KONSULTIM FALAS!

*Flasim shqip, ju kuptojmë!*

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545
info@dotech.uk
www.dotech.uk



**MBULOJMË GJITHË BRITANINË**

- London
- Manchester
- Birmingham
- Leicester
- Dhe më shumë...

**PROFESIONALIZËM**
Dhe përkushtim ndaj çdo projekti

**ÇMIME TË ARSYESHME**
Paguani me këste që ju përshtaten

**REZULTATE TË MATSHME**
Më shumë klientë për biznesin tuaj

DOTECH WEBSITES – PARTNERI JUAJ PËR SUKSESIN ONLINE!

# BIRN: KUSH PËRFITON NË SHQIPËRI NGA STATUSI I "INVESTITORIT STRATEGJIK"?



Kërkesa "Shqipëria nuk shitet" keqinterpretohet kur paraqitet si refuzim i çdo investimi. Interpretimi i saj i saktë është procedural: çdo tjetërsim i së përbashkëtës duhet bërë në dritë të diellit – me çmim të përcaktuar nga konkurrenca, me leje të botuara, dhe me përfitues të identifikueshëm.

Një kompani që ka marrë një copë të bregdetit të Adriatikut e ka adresën zyrtare në katin e 12-të të European Trade Centre në Tiranë, ku, sipas një hetimi të BIRN-it, "nuk kishte as tabelë emri, dhe punonjësit e ndërtesës thanë se nuk njihnin asnjë kompani me atë emër". Një pasuri që u përket të gjithëve mban emrin e një kompanie që nuk gjendet dot as në adresën e vet – sepse pronësia e saj është ndërtuar si një varg kutish, njëra brenda tjetrës dhe kutia e fundit është bosh. Te ky boshllëk nis problemi.

Përpjekjet për ta ngushtuar debatin publik për Zvërnecin në një përballje midis mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit ekonomik, në rastin më të mirë nuk ndihmojnë. Në atë të keqin janë mashtruese. Pyetja e vërtetë është ekonomike dhe shumë e thjeshtë: kur shteti transferon te pak privatë një pasuri që u përket të gjithëve, a e merr publiku vlerën e vërtetë në këmbim – dhe a mund ta verifikojë këtë? Në rastin e projekteve në Sazan dhe Zvërnec, të tria hallkat që do të lejonin një përgjigje – çmimi, procedura dhe identiteti i përfituesit – mbeten të errëta. Kjo, jo flamingot, është arsyeja pse çështja ka rëndësi për çdo taksapagues.

**Anatomia e statusit "strategjik"**

Ligji mbi investimet strategjike krijon një kategori investitorësh me trajtim të privilegjuar. Sipas një analize të Citizens.al, ky status "krijoi një sistem privilegjesh që u dha kompanive private akses të veçantë në tokë publike, bregdet, plazhe, zona turistike, ishuj dhe pasuri me interes publik", përfshirë "qira simbolike" dhe "procedura të negociuara drejtpërdrejt me shtetin". Për projektin në fjalë, sipas revistës Forbes, qeveria shqiptare i dha miratimin paraprak planit të Sazanit në dhjetor 2024, duke i akorduar statusin e investitorit strategjik që lejon miratime më të shpejta. Sipas kushteve të marrëveshjes së nënshkruar në 2024, kompania nuk do të taksohet për 10 vjet gjatë ndërtimit.

Nga ana ekonomike, ky është një subvencion. Ai mund të jetë i justifikuar nëse projekti prodhon më shumë vlerë publike sesa heq. Por për ta gjykuar këtë, qytetari duhet t'i shohë kushtet – dhe këtu problemi bëhet i prekshëm.

**Fitimet private, kostot publike**

Struktura e marrëveshjes ndan përfitimet nga kostot në mënyrë sistematike. Investitori merr; qytetari paguan. Investitori merr një aset bregdetar të pazëvendësueshëm, leje të shpejta dhe një çlirim tatimor dhjetëvjeçar gjatë ndërtimit. Qytetari mbart kostot që rrallë shfaqen në një faturë. Ja disa prej tyre:

– Humbje kapitali natyror. Sipas Wetlands International, zona është "shtëpi e më shumë se 200 llojeve të shpendëve shtegtarë – përfshirë flamingot, fokat mesdhetare dhe breshkat e detit që bëjnë fole", që Shqipëria është zotuar ta mbrojë sipas një numri konventash e marrëveshjesh. Mbrojtja u dobësua në dy hapa: sipas një hetimi të BIRN-it, në 2021 qeveria "uli statusin e mbrojtjes së ekosistemit Pishë Poro-Nartë, e reduktoi atë me mbi 5 mijë hektarë"; pastaj në 2024, siç raportojnë EuroNatur dhe reporter.al, amendamentet e Ligjit për Zonat e Mbrojtura "dobësuan masa të rëndësishme mbrojtëse" dhe "hapën rrugë ndërtimeve me pesë yje". Kjo humbje nuk kthehet me para;

– Të ardhura tatimore të munguara gjatë dhjetë viteve të ndërtimit – një transferim i drejtpërdrejtë nga arka publike te bilanci privat;

– Të ardhura të munguara nga qiraja, kur toka publike jepet me "qira simbolike";

– Kosto oportune e tokës publike të dhënë me "procedura të negociuara drejtpërdrejt" e jo me garë konkurruese – pa një procedurë të hapur, qeveria nuk mund të provojë se mori çmimin e tregut.

Le ta pranojmë me bujari premtimin e qeverisë. Projektet paraqiten si investime shumë-miliardëshe dhe si motor zhvillimi për një zonë të vendit që e ka atë të nevojshëm.

Edhe sikur ajo shifër të realizohej e plotë, ajo duhet peshuar kundër faturës: dhjetë vjet pa taksa, tokë publike me qira simbolike, mbi 5,000 hektarë mbrojtje të hequr që në 2021, dhe një kosto strategjike që sapo është shfaqur – siç raporton revista Newsweek, më 17 qershor 2026 Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë që kërkon shfuqizimin e amendamenteve, ndërsa përputhja mjedisore dhe shteti i së drejtës janë kushte thelbësore të anëtarësimit në BE.

Një investim krijon vlerë neto vetëm nëse përfitimi tejkalon këtë faturë – dhe askush nuk e ka bërë këtë llogari publikisht.

**Mjegulla rreth pronësisë: guacka dhe trust-i**

Elementi që e shndërron një marrëveshje të diskutueshme në një problem qeverisjeje është fshehja e përfituesit. Shpjegimi i dy koncepteve teknike e bën fare të qartë. Një kompani-guackë është një subjekt që ekziston vetëm në letër, pa aktivitet real, dhe shërben për të mbajtur një aset ose një kontratë.

Një trust holandez është një shërbim që figuron si pronar zyrtar në vend të personit të vërtetë, duke bërë që emri i përfituesit të mos shfaqet në regjistrat publikë.

Sipas hetimit të BIRN-it, kompania shqiptare "Zvërnec South Adriatic Development" u krijua në gusht 2024 dhe "zotërohet nga një zinxhir kompanish guackë nën menaxhimin e trustit holandez Dutch Trust Management B.V."

Një prej subjekteve në atë strukturë, "Blue Industries Investment Holding B.V.", "zotërohet nga pesë individë anonimë nga Shqipëria, emrat e të cilëve mbrohen ligjërisht pasi asnjëri nuk zotëron më shumë se 25% të aksioneve". Nuk është rastësi që adresa e saj zyrtare është një kat pa tabelë emri: kompania është ndërtuar që të mos gjendet.

Sipas BIRN-it, kjo strukturë siguroi dy leje zhvillimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit, i kryesuar nga Kryeministri, në janar dhe prill 2025 – leje që "nuk janë zbardhur ende", ndërsa "kompania që ka përfituar lejet në KKT ka pronësi të panjohur".

Struktura funksionon si kukullat matrioshka: çdo kukull ka një tjetër kukull brenda, derisa arrihet një juridiksion ku ligji e lejon që emri i fundit të mbetet i padukshëm. Kur një aset publik i kalon një subjekti pronarët e fundit të të cilit janë të fshehur, qytetari nuk mund as të identifikojë që po pasuron, as të verifikojë nëse ka konflikt interesi. Për këtë arsye, më 1 qershor 2026, SPAK-u "ka konfirmuar zyrtarisht se ka nisur hetime". Hetimi është në proces dhe asnjë përgjegjësi nuk është vërtetuar në gjykatë; por vetë nevoja për të hetuar tregon se transparenca minimale mungon.

**Vetëm 2 nga 44**

Nëse ligji i investimeve strategjike do ti kishte shërbyer qëllimit të shpallur – tërheqjes se kapitalit të huaj – do të prisnim një shumicë projektesh me investitorë të huaj.

Ka ndodhur e kundërta: sipas Citizens.al, "deri në vitin 2023 vetëm 2 nga 44 projektet e miratuara rezultonin investime tërësisht të huaja".

Ky raport sugjeron se instrumenti funksionon kryesisht si kanal për t'u dhënë pasuri publike interesave të lidhur brenda vendit – ajo që literatura ekonomike e quan rent-seeking: përfitim i nxjerrë jo nga krijimi i produkteve a shërbimeve me vlerë, por nga aksesi i privilegjuar te vendimet shtetërore. Rasti i Zvërnecit është forma më e skajshme e së njëjtës logjikë.

Kërkesa "Shqipëria nuk shitet" keqinterpretohet kur paraqitet si refuzim i çdo investimi. Interpretimi i saj i saktë është procedural: çdo tjetërsim i së përbashkëtës duhet bërë në dritë të diellit – me çmim të përcaktuar nga konkurrenca, me leje të botuara, dhe me përfitues të identifikueshëm.

Këto nuk janë kërkesa të tepruara. Janë kushte minimale që i lejojnë shqiptarët të gjykojnë nëse qeveria po vepron si administruese e pasurisë së tyre apo si ndërmjetëse e saj.

Një bregdet që u përket të gjithëve nuk mund t'i kalojë një adrese ku askush nuk njeh asnjë kompani. Derisa çmimi, procedura dhe identiteti i përfituesit të bëhen publikë, supozimi i arsyeshëm nuk është keqbesimi por dyshimi i informuar. Dhe dyshimi i informuar, i shprehur paqësisht, është përkufizimi mirëfilltë i qytetarisë. Këtë shqiptarët po e tregojnë në shesh.

**(Reporter)**



ERV HEATING

# BEAT THE HEAT. STAY COOL. ALL YEAR ROUND.

**Comfort** you can feel. **Quality** you can trust.

MAXIMUM COOLING | ENERGY EFFICIENT | QUIET OPERATION | EXPERT ENGINEERS

**GET A FREE QUOTE**
Quick, free and no obligation

**07411382856**
Speak to our friendly team today

CALL US TODAY!
**07411382856**
Local Experts, Professional Service

WHEN IT'S HOT OUTSIDE, WE MAKE IT COOL – INSIDE –

F-GAS CERTIFIED
FULLY QUALIFIED & CERTIFIED ENGINEERS

SCAN ME!
Visit our website for more information

## OUR SERVICES



### INSTALLATION
Supply and install high quality air conditioning systems tailored to your needs and budget.



### REPAIR
Fast, efficient repair service to get your air conditioning system working again.



### SERVICING
Regular servicing for optimal performance, efficiency and long term reliability.



### COMMERCIAL
Bespoke air conditioning solutions for offices, shops, restaurants and commercial properties.

### PLUMBING & HEATING
- Boiler installations & repairs
- Hot water cylinder installations
- General plumbing & pipework
- Bathroom installations
- Leak detection & repairs
- Emergency plumbing services



### CENTRAL HEATING
- Full central heating systems
- Radiator installations
- System upgrades & power flushing
- Thermostat & controls
- Boiler servicing & maintenance
- Energy efficient solutions






### THE COMFORT YOU DESERVE. ALL YEAR ROUND.

**COOLS FAST** – Instant relief on hot days

**PERFECT TEMPERATURE** – Comfort all year round

**CLEAN AIR** – Breathe easy with fresh, filtered indoor air

Don't let the heat get to you.
*We'll keep you cool.*

### LOCAL EXPERTS. QUALITY YOU CAN TRUST.
- Fully qualified & F-Gas certified engineers
- Honest advice & transparent pricing
- Clean, tidy and respectful service
- Covering Surrey and surrounding areas

WE WORK WITH TRUSTED BRANDS

MITSUBISHI ELECTRIC | DAIKIN | Panasonic heating & cooling solutions | LG Life's Good | safe

Google 5.0 ★★★★★ Based on 100+ reviews

07411382856 | info@ervheating.co.uk | www.ervheating.co.uk

Shpresa Programme
Inspiring hope & change



# SUMMER HOLIDAY PROGRAMME 2026

## FREE Activities for Children & Young People Ages 5–11 and 12–16

TWO WEEKS OF FUN, LEARNING & ADVENTURE!

- 🎨 *Fun Activities Every Day:*
- ✨ *Arts & Crafts (Drawing, painting, paper modelling)*
- 🎭 *Drama & Storytelling (Role play, shows & confidence-building)*
- 🎶 *Music & Dance (Group singing & dancing)*
- ⚽ *Sports & Active Games*
- 🌳 *Outdoor Adventures (Nature walks& park games)*
- 🏃 *At least 60 minutes of physical activity every day*
- 🍎 *Healthy Meals & Snacks Provided*

Spaces are limited book early!

### DATES & TIME
17–28 August 2026
Monday–Friday | 10:00am–2:00pm

### LOCATION
Mansfield House
Newham, E13 9EF

### AGES
5–11 years & 12–16 years
*MUST BE NEWHAM RESIDENTS*

SCAN TO REGISTER!

## BOOK YOUR PLACE NOW!
SCAN THE QR CODE TO BOOK

# VRANINA HOME, SHTËPIA KU RINDËRTOHET MË SHUMË SE NJË ËNDËRR...

ZENEL KUÇANA









Gjithçka ishte gati. Me përkujdesjen më të madhe, u ishte dhënë dora e fundit edhe detajeve më të vogla.
Po hapej një kapitull i ri për "Vranina group"; "Vranina Home", një fabrikë moderne e pajisur me teknologjinë më bashkëkohore.
Padyshim ky ishte një ndër momentet më të rëndësishme, në udhëtimit e Vranina Group.
Çiltërsia e Ukë Nimanit, pronarit të Vraninës, reflektonte edhe krenarinë e një suksesi të jashtëzakonshëm, duke përfaqësuar më së miri guximin dhe vlerat e pamohueshme, bashkë me vullnetin për të krijuar vende pune, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

I gjithë stafi i Vranina Group ishin tejet të përkushtuar, pasi për ta ishte një ditë e madhe. Nderonin me pjesëmarrjen e tyre ministrja Artane Rizvanolli, kryetari i komunës Gazmend Muhaxherri, deputeti Taulant Kelmendi, zëvendësmistra të ekonimisë, znj.Triera Kasumi Berisha, z.Getoar Mjeku dhe zevendsminister i Drejtesisë z.Genc Nimani, Komandant z. Idriz Atashi, Rektori Prof . Dr. Armand Krasniqi etj

Nuk kishte se si të mos ndjeheshin krenarë familja Nimani, për arritjet e tyre të jashtëzakonshme.
Historiku i suksesit të Vranina Group është padyshim historia e krenarisë, sacrificës, guximit, modelit të besimit të palëkundur.

***Ja çfarë na thanë përfaqësuesit e Vranina Group :***

Historia jonë fillon në vitin 1993, kur themeluam kompaninë tonë me emrin Vranina.
Gjithçka nisi me një dyqan të vogël tregtar, por me një ëndërr shumë më të madhe se vetë hapësira ku punonim.
Që në ditën e parë besuam se kapitali ynë më i madh nuk do të ishte vetëm ajo që shisnim, por mënyra se si punonim: me ndershmëri, korrektësi dhe respekt për çdo klient.
Në vitin 1995, u përballëm me sfidën tonë të parë.
Regjimi i asaj kohe nuk lejoi përdorimin e emrit "Vranina", duke e konsideruar atë si emër nacionalist.
U detyruam ta ndryshonim emrin e kompanisë në "Oqeani".
Por ndryshoi vetëm emri.
Jo karakteri.
Jo vizioni.
Jo dëshira për të ndërtuar diçka që do t'i rezistonte kohës.
Në vitin 1996, filluam importin e mobilieve për zyra nga Gjermania.
Ky ishte hapi që ndryshoi drejtimin e kompanisë sonë.
Ishte momenti kur kuptuam se me punë, seriozitet dhe besim mund të arrinim shumë më tepër.
Hap pas hapi fituam besimin e klientëve tanë dhe vendosëm themelet e asaj që sot është Vranina Group.

Pastaj erdhi periudha më e vështirë e jetës sonë.
Vitet 1998–1999 sollën luftën në Kosovë.

Ashtu si për mijëra familje shqiptare, edhe për ne ajo luftë la pasoja të rënda.
Gjithçka që kishim ndërtuar me vite pune, sakrifice dhe përkushtimi u shkatërrua.
Brenda pak muajsh humbëm atë që na ishte dashur vite ta krijonim.
Ishte një goditje e rëndë.
Por nuk humbëm kurrë atë që kishte më shumë vlerë se çdo ndërtesë apo pasuri.
Nuk humbëm besimin.
Nuk humbëm vullnetin.
Nuk humbëm dëshirën për të vazhduar.
Dhe pikërisht ai besim na dha forcën të ngriheshim përsëri.
Në fund të vitit 1999, filluam gjithçka nga zero.
Pa luks.
Pa lehtësi.
Por me një bindje të palëkundur se puna e ndershme, këmbëngulja dhe besimi do të na çonin përsëri përpara.
Hapëm showroom-in tonë të parë në qendër të Pejës dhe rikthyem me krenari emrin që gjithmonë kishte qenë pjesë e identitetit tonë – Vranina.
Aty nuk po rindërtonim vetëm një biznes.
Po rindërtonim një ëndërr.
Po rindërtonim besimin e klientëve tanë.
Dhe po i tregonim vetes se edhe pas sfidave më të mëdha, njeriu mund të fillojë përsëri, nëse nuk heq dorë.

Në vitin 2002, vazhduam rrugën e zgjerimit me hapjen e showroom-it të dytë.
Për ne nuk ishte thjesht një pikë e re shitjeje.
Ishte dëshmia se besimi i klientëve po rritej çdo ditë.
Çdo klient që hynte në dyert tona nuk ishte vetëm një blerës.
Ai bëhej pjesë e historisë sonë.

Në vitin 2006, vendosëm të sfidonim veten edhe një herë.
Hymë në sektorin e hotelerisë dhe gastronomisë me ndërtimin e Hotel Vranina.
Ishte një investim që kërkonte guxim, përgjegjësi dhe një vizion të ri.
Nuk ndërtuam vetëm një hotel.
Ndërtuam një vend ku njerëzit do të prisnin mysafirët e tyre, do të festonin momentet më të bukura të jetës dhe do të krijonin kujtime që zgjasin përgjithmonë.
Aty ku dikush festonte martesën.
Dikush tjetër ditëlindjen.
Dikush një sukses.
Dhe ne kuptuam se nuk po ndërtonim vetëm objekte.
Po ndërtonim vende ku njerëzit krijojnë kujtime.

Në vitin 2014, zgjeruam aktivitetin edhe në sektorin industrial me Vranina Stone.
Ky investim shënoi fillimin e një etape të re.
Filluam të ndërtojmë një grup kompanish që operojnë në sektorë të ndryshëm, por që udhëhiqen nga të njëjtat vlera:
Puna.
Disiplina.
Përgjegjësia.
Dhe cilësia pa kompromis.

Në vitin 2021, vazhduam të investojmë me hapjen e Vranina Palace.
Një projekt modern, i ndërtuar sipas standardeve më të larta, që sot është bërë pjesë e momenteve më të bukura të mijëra familjeve.
Nuk ka kënaqësi më të madhe sesa të shohësh njerëzit duke festuar lumturinë e tyre në një hapësirë që është ndërtuar me zemër.

Në vitin 2025, hapëm showroom-in tonë të tretë në Prishtinë.
Ky ishte një tjetër hap i rëndësishëm në zgjerimin e kompanisë sonë.
Por për ne, zgjerimi nuk ka qenë kurrë qëllim në vetvete.
Qëllimi ynë ka qenë gjithmonë të jemi më pranë klientëve tanë, t'u ofrojmë më shumë zgjedhje, më shumë cilësi dhe të njëjtin besim që kemi ndërtuar ndër vite.

Dhe sot…
Po jetojmë një nga momentet më të rëndësishme në historinë e Vranina Group.
Sot po hapim një kapitull krejtësisht të ri.
Vranina Home.
Ky nuk është vetëm investimi ynë më i madh deri më sot.
Ky është realizimi i një vizioni që është ndërtuar gjatë më shumë se tridhjetë viteve.
Një fabrikë moderne, e pajisur me teknologjinë më bashkëkohore dhe e ndërtuar sipas standardeve më të larta evropiane.
Por kjo fabrikë nuk përfaqëson vetëm beton, çelik dhe makineri.
Ajo përfaqëson guximin për të investuar.
Besimin për të prodhuar.
Vullnetin për të krijuar vende të reja pune.
Dhe përgjegjësinë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës.
Ne besojmë se produktet që do të dalin nga kjo fabrikë do të mbajnë me krenari emrin Vranina Home dhe vulën "Made in Kosovo", duke dëshmuar se edhe nga Kosova mund të prodhohen produkte që konkurrojnë me cilësi në tregjet evropiane.
Kur shikojmë pas, nuk shohim vetëm ndërtesa apo investime.
Shohim netë pa gjumë.
Shohim vendime të vështira.
Shohim sakrifica.
Shohim njerëz që nuk reshtën kurrë së besuari.
Dhe kuptojmë se kjo fabrikë nuk është thjesht një objekt industrial.
Ajo është simboli i një rrugëtimi që dëshmon se me punë të ndershme, përkushtim dhe besim, edhe ëndrrat më të mëdha bëhen realitet.
Sepse ndërtesat ndërtohen me beton dhe çelik.
Por kompanitë ndërtohen me njerëz.
Me besim.
Me fjalën e mbajtur.
Dhe me punë të ndershme.
Këto kanë qenë vlerat tona që nga viti 1993.
Dhe këto do të vazhdojnë të jenë themeli i çdo hapi që do të ndërmarrim në të ardhmen.
Sepse ne nuk ndërtojmë vetëm fabrika.
Ne ndërtojmë besim.
Ne ndërtojmë mundësi.
Ne ndërtojmë të ardhmen.
Ndërtojmë për kohën.
Prerja e shiritit të Vranina Home nga pronari i kompanisë dhe ministrja e Ekonomisë dhe kryetari i Komunës së Pejës, ishte një moment simbolik, por tepër domethënës për Vranina Home, një hap që premton sukses të padiskutueshëm.

Vranina Home mbetet shtëpia ku rindërtohet më shumë se një ëndërr.

# FLAMINGOT DUHET T'I INJOROJNË HIJET E SË DJESHMES

**ANDI BUSHATI**

Strategjia e një pjese të madhe të mbrojtësve oligarko-mediatikë të autokratit është të bëjnë kamikazin duke thithur mbi vete debate shterpë që largojnë vëmendjen nga thirrja: "Rama jeeeepe dorëheqjeeeeeen".

Disa ditë më parë, pasi kishim përfunduar emisionin "Të Paekspozuarit" të Ylli Rakipit, u takova me disa prej atyre që mund të konsiderohen si organizatorët e revolucionit të flamingove. Përgjatë bisedës, njëri prej tyre, më bëri një ftesë sa spontane, po aq dhe të çiltër. "Pse, nuk vjen aty në shesh të flasësh, na ndihmon"- më tha, duke më ngulur sytë me vetëbesimin e dikujt që mbron një kauzë të drejtë.

I kapur në befasi, me sikletin e përhershëm të atij që duhet të refuzojë dikë që e simpatizon, u përpoqa t'i shpjegoj arsyet e përgjigjes sime negative.

E para, është personale i thashë. Unë mendoj se një gazetar që përshkruan, apo mban qëndrime për ngjarjet, duhet të ruajë një distancë të domosdoshme ndaj asaj që ndodh dhe protagonistëve që e prodhojnë. Këtë parim e kam ushtruar prej kohësh, ndonëse e di që ekziston dhe një model tjetër, ai i opinionistit aktivist, që rreket ta ndyshojë shoqërinë, jo vetëm përmes shkronjave, por edhe përmes veprimit. Por, në kushtet kur shumë kolegë, paguhen si këshilltarë të liderëve gjatë ditës, për t'u shfaqur si të pavarur në editorialet apo emisionet e mbrëmjes, unë kam zgjedhur këtë hendek higjenik, në radhë të parë për të qenë sa më i kthjellët vetë dhe më pas për të ruajtur sa me tepër besueshmëri që të jetë e mundur.

Por e dyta, dhe më e rëndësishmja, u përpoqa të arsyetoj, unë besoj se duke



u shfaqur përkrah jush, më shumë ju dëmtoj, sesa ju ndihmoj. Në këtë treg ku militoj prej gati tre dekadash – thashë- unë kam bërë betejat e mia (sipas meje – këtë e gjykon tjetërkush – në krahun e së drejtës dhe moralit), në të cilat, në një farë mënyre, kam krijuar antipati, njerëz që s'më pëlqejnë, të tjerë që se kanë më besimin se mund tu them të vërtetën. Ashtu si në çdo përballje, ku edhe fitimtari absolut ka shumë për të humbur edhe brezi im, në betejat me Berishën e parë, Nanon, Metën, Berishën e dytë dhe Ramën, sado të drejtë që të ketë pasur, ka paguar një haraç të lartë me brerjen e besueshmërisë tek një pjesë e publikut. As unë, as kërkush nuk ka pse e transferon këtë kosto tek levizja e juaj e re, e fresket, që në thelb nuk ka të bëjë aspak me hijet e së djeshmes. Idetë e reja kërkojnë edhe fytyra të reja. Prandaj druaj se ju bëj dëm, po të jem aty mes jush – u thashë përmbledhtas.

Për këtë argumentin e fundit, u binda katërcipërisht se kisha të drejtë, kur e pashë emrin tim të ndërkallur në mënyrë absurde, si të lidhur me protestën, ose me atë pjesë të saj që denonconte biznesmenët sharlatanë që kanë rrjepur Shqipërinë, duke qenë njëkohësisht servilë dhe përfitues të pushtetit.

Natyrisht që si shumëkënd edhe mua më entuziazmoi si një gjetje inteligjente fushata për të lënë review negative kundër atyre milionerëve që kanë bërë para në kurriz të shqiptarëve. Madje dhe e shpreha me zë të fortë këtë, pa qenë as pjestar në aksion, as aktiv në zbritjen e yjeve. Por vetëm kaq. Thjeshtë me peshën e përgjegjësisë për të thënë fjalën për një gjë që i duket e drejtë.

Prandaj më shkaktoi habi, kur e pashë veten të përshkruar jo në rolin e opinionistit, por në atë të protagonistit. Pyetja e parë që më erdhi në mend ishte: "Po ç'ne?" Pse duhej të më jepej kjo medalje? Pse duhet të më atrubuohej merita e një gjetjeje kaq inteligjente?

Nuk mu desh shumë për ta kuptuar. E gjithë përpjekja e armiqve të revolucionit të flamingove, e militantëve të status quos-ë, e një sistemi të cilin e sundon Rama, por ku përfitojnë nga pak të gjithë, është ta mbajnë debatin tek polemikat e vjetra. E vetmja gjë që i tmerron është thirrja për një "Shqipëri të re", prandaj shfrytëzojnë çdo shkëndijë për të ndezur zjarrin e sherreve të së djeshmes. Ajo gjë që nuk duan të pranojnë, në asnjë mënyrë, është shfaqja në skenë e një gjenerate të re, që janë bërë 30 vjeçarë me Ramën në pushtet dhe tani kanë dalë në sheshe me thirrjen :"Mjaft më".

Këtë makth e sheh të pasqyruar tek të ashtuquajturit biznesmenë qesharakë që janë gati të bëhen kamikazë për të mbrojtur liderin e tyre politik, përmes të cilit bëjnë para, madje qoftë edhe me çmimin e minimit të reputacionit të kompanive të tyre. Nga më groteskët, njëri prej tyre, propozoi shtyrjen e protestave për në vjeshtë, deri sa të mbyllej sezoni turistik.

E njëjta gjë vihet re edhe te ato televizione kombëtare, që janë baltosur në mënyrë të pakthyeshme nga krahasimi me CNN, BBC, ZDF dhe mediat e shkruara si The Guardian, New York Times, Le Mode, Der Spiegel etj.

Po i njëjti fenomen lexohet edhe tek ata komentatorë që janë gati të bëjnë kamikazin, vetëm për të marrë mbi gjoksin e tyre pa vlerë shigjetat që në fakt i janë drejtuar Edi Ramës.

Qëllimi i tyre është vetëm një: të mbajnë gjallë debatin e së djeshmes, pozitë- opozitë, polemikat Rama-Berisha, përplasjet me debatuesit e tyre të dikurshëm, sherret biznes- gazetarë, me synimin e qartë për të fshehur kointradiktën më të re që është shpërfqur në shoqëri, e që sintetizohet në sllloganet "Ju erdhi fundi", "Rama jeeeeepe dorëheqjeeeeen".

Për të daravitur jehonën e tyre, të gjitha këto grupime janë gati të bëjnë harakiri e të zhyten në llumin e së shkuarës, si në të vetmin gjiriz që i mban mbi ujë.

Këtë kuptova nga fabula ku u gjeta i përfshirë aksidentalisht. Pikërisht kjo përvojë personale ma përforcoi bindjen se ajo që i kisha thënë plot drojë, njërit prej drejtuesve të protestës, me frikën se mos e lëndoja, ishte mëse e drejtë. Shqipëria e Re, e ndryshme, e bukur, iluzive, që kërkon kjo gjeneratë, duhet të shkëputet nga njollat e së djeshmes. Ata kanë të drejtën të imagjinojnë botën në mënyrën e tyre. Mund të fitojnë, apo mund të dështojnë, kjo ka pak rëndësi. Kryesorja është se ata duhet të provojnë pa ne.

Brezi ynë mund të ndahet mes "të mirëve" që e përkrahin, apo "të këqijve" që e luftojnë. Por ai i ka bërë betejat e veta, herë duke humbur, apo herë duke fituar. Të gjitha këto kanë prodhuar atdheun e sotëm. Atë vend që ata po duan ta ndryshojnë.

Dhe nëse një ditë do ia dalin këtë do arrijnë ta bëjnë vetëm duke injoruar borizanët e lodhur të një periudhe të tejkaluar e cila, mbajtja gjallë e së cilës, sot për sot, i intereson vetëm një njeriu: Edi Ramës.

# SHTATË ARGUMENTE KUNDËR SHITJES SË TOKËS SË HUAJVE

**ARTAN FUGA**

Shitja e tokës bujqësore të huajve si në Evropë?

Seriozisht e ke?

Dëgjova një kuvendar që tha sot në Kuvend me retorikë patetike se ndryshimi i ligjit që lejon shitjen e tokës së huajve bëhet për të afruar dhe njehsuar legjislacionin e Shqipërisë me atë evropian në kuadrin e integrimeve evropiane.

Qenka një sukses pra! Kështu i mbyllkan kapituj këta? Qenka me mbyll vërtet kapitullin e marrëdhënies së shqiptarit me tokën!

Hap kapitull, mbyll kapitull!
Tani kuptova shumë!
E ke gabim shok, zotëri, çfardo qofsh komunist, ballist, zogist, agrarist, ambjentalist, a çfardo!

E para, nëse duhet ndryshuar ligji, duhet negociuar që ky modifikim që lejon shitjen e tokës së huajve mund të bëhet dhe të hyjë në fuqi vetëm pasi Shqipëria të hyjë në BE, sepse poqese ndodh përpara ka efekte të tjera.

E dyta, patjetër integrim evropian, ligji mund të lejojë shitjen të huajve të tokës, por më përpara barazoni ligjin e tokës dhe të pronës në Shqipëri me ligjet evropiane. Pra, kthejani tokën pronarëve të saj, atyre që e kanë pasur dhe pastaj ata po të duan ta shesin. Jo pasi keni bërë një ligj superkomunist mbi tokën, ndarë në ngastra, tani mbi atë vendosni një ligj gjoja evropiane. Mashtrim i madh historik me pasoja të rënda!

E treta, doni ta bëni ligjin si në Evropë, pra toka t'u shitet edhe të huajve, patjetër, tregu i tokës si çdo treg, por më parë siguroni si në Evropë mbështetjen për bujkun, agrikultorin, bëjeni bujkun shqiptar fermer si në Evropë dhe aplikoni ndihma si në Evropë për fshatarin bujqësor shqiptar. Pastaj shihni si e shet tokën ai!

E katërta, patjetër ligjet si në Evropë, por ju po negocioni që edhe të drejtën e vetos ta merrni me një vonesë, pas një faze përgatitore, përse nuk thoni një fjalë që tregu i tokës i hapur ndaj të



huajve, edhe ai të marrë veprim pas disa dekadash, kur edhe bujqësia të mund t'i shpëtojë rrënimit ku e keni futur në këto dekada?
E pesta, pse njësoj e shet tokën sa një parcelë një bujk i varfër shqiptar që s'ka as mekanikë, as financa, as fuqi punuese se çunat dhe gocat i kanë ikur në emigrim, dhe një fermer gjerman ta zemë që i ka të gjitha këto, apo polak, hungarez, etj. që ta shtyp kokën me autokombajna ultramoderne? Dini të krahasoni apo jo?
E gjashta, po si në BE, qeveria iu ka dhënë model zhvillimi bujqëve dhe blegtorëve, u ka hapur tregje, apo e përmbyt tregun shqiptar me zarzavate me pesticide të ardhura nga dreqi. Apo ka kontrolle si në Evropë për produktet e huaja? Se kështu fshatari i varfër shqiptar do ta shesë tokën për pesë kacidhe para një të huaji afendiko, sepse nuk ka se çfarë e bën atë. Tregu i përmbytur nga produkte të huaja. Do ta shesi tokën sikurse sheh votën!

E shtata, a është argument se meqë Agron Shehaj paska blerë vilë dhe truall përreth saj në Itali, atëhere edhe bujqit shqiptarë duhet të kenë tani një ligj që u lejon shitjen e tokës bujqësore të huajve... Cfarë logjike!

E dini more se sa përqind e tokës bujqësore në Itali mund të ketë pronar të huaj? Kodrat, fushat e Toskanës, Siçilisë, Lombardisë, etj., lulëzojnë nga fakti se bujqësia atje është e zhvilluar, jo e lënë në mëshirë të fatit nga politika si këtu dhe italiani të jep zemrën, por jo tokën.

Kështu duan ta diskreditojnë idenë e integrimit evropian? Se nuk kam shpjegim tjetër!
Kur dëgjova atë arsyetim bosh, thjesht gjoja juridik, thjesht pa asnjë logjikë krahasuese, pa i hyrë në thelb problemit, krejt manipulues, më erdhën lotë zëmërimi në sy!

Dotech
Websites

POROSISNI
# BUSINESS CARDS
*Profesionale*

**PËR BIZNESIN TUAJ!**




**Mos rrini anonim – jepini frymëmarrje biznesit tuaj.**

Kartat profesionale të biznesit janë mënyra më e thjeshtë dhe më efektive për të lënë një përshtypje të parë të shkëlqyer te klientët tuaj.

## NE U KUJDESEMI PËR:

- DIZAJN MODERN DHE PROFESIONAL
- PRINTIM ME CILËSI TË LARTË
- DORËZIM ME POSTË NË TË GJITHË MBRETRINË E BASHKUAR
- CMIME TË ARSYESHME




*Dizajnojmë ne,* | **JU DËRGOJMË ME POSTË!**




NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

ADRESA E ZYRËS:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

WEB DESIGN | SEO | E-COMMERCE | DIGITAL MARKETING

# LETËR E HAPUR NJERËZVE TË DREJTËSISË: SHTET I SË DREJTËS APO BANDË E MADHE PLAÇKITËSISH

**FATOS LUBONJA**

***Kambanat e kësaj proteste nuk bien vetëm për Edi Ramën, ministrat, parlamentarët, qeverisësit dhe plaçkitësit e tij, ato bien edhe për gjykatesit dhe prokuroret. Pyetja që ngrihet sot nga njerëzit në proteste është: a jeni ju në shërbim të asaj drejtësie që në Kushtetutën tonë formulohet në trajten "E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit." apo, si në kohën e Enver Hoxhës, jeni në shërbim të bandës së plaçkitësve që e shkel përditë kufirin e së drejtës?***



Zonja dhe Zotërinj të Drejtësisë,

Po e filloj duke ju rikujtuar një anekdotë që vjen nga antikiteti e që shpresoj se shumë nga ju mund ta kenë hasur në tekstet e studimeve për drejtësi:

Flota e një mbreti të fuqishëm kapi në det një anije pirate dhe e çoi kryepiratin të gjykohej para mbretit. Ishte një kohë kur mbreti kishte pushtet absolut d.m.th. bënte edhe ligjvënësin edhe gjykatësin. "Me ç'të drejtë e zapton ti detin dhe plaçkit në të?" – e pyeti mbreti piratin.

Ky, duke u ndjerë i pashpresë, mori guximin dhe i tha: "Me të njëjtën të drejtë që zapton dhe plaçkit ti, por unë e bëj vetëm me një anije dhe quhem plaçkitës kurse ti e bën me një flotë të madhe dhe quhesh mbret."

Sikurse shpresoj ta dini kjo anekdotë ngre një çështje themelore lidhur me të drejtën. Shën Agostini e ka formuluar në formën e pyetjes: çfarë do të ishte një shtet pa të drejtën përveçse një bandë e madhe plaçkitësish? Ose ndryshe: pa të drejtën një bandë plaçkitësish a nuk do të ishte veçse embrioni i një shteti?

Besoj se nuk është nevoja të zgjatem me ju përsa i përket kuptimit ligjor, politik e moral të kësaj anekdote. Por nuk mund të rri pa ju kujtuar historinë tonë.

Kam parasysh bandën e madhe të Enver Hoxhës që u bë shtet dhe i shkaktoi për afro gjysmë shekulli popullit shqiptar krime me pasoja të pariparueshme duke u plaçkitur deri dhe jetën, dinjitetin dhe lirinë dhe se, në prizmin e anekdotës në fjalë, nuk mund të mos kujtojmë se një nga instrumentet kryesore që përdori kjo bandë kanë qenë pikërisht organet e drejtësisë: hetuesit, prokurorët dhe gjyqtarët.

E pra, zonja dhe zotërinj të drejtësisë, kanë kaluar 36 vjet nga rënia e atij regjimi dhe populli shqiptar është ngritur në një protestë masive që e mori nismën ngaqë rojet e një oligarku të qeverisë tërhoqën zharg një qytetar që protestonte për shkak se po i plaçkitnin pronën – dhe e gjitha kjo në sytë pasivë të policisë së shtetit.

Ashtu siç e kuptoj unë empatia e ndaj këtij protestuesi, që i ngriti shqiptarët në këmbë, e ka burimin tek fakti se ata vazhdojnë të vuajnë si dikur nën sundimin e një shteti bandë e madhe plaçkitësish që me krimet dhe padrejtësitë e tij po ua bën vendin gjithnjë e më të pajtueshëm.

Zonja dhe Zotërinj të Drejtësisë, sikurse mund t'i keni dëgjuar, kambanat e kësaj proteste nuk bien vetëm për Edi Ramën, ministrat, parlamentarët, qeverisësit dhe plaçkitësit e tij, ato bien edhe për ju. Pyetja që ngrihet sot nga njerëzit në proteste është: a jeni ju në shërbim të asaj drejtësie për të cilën flet Agostini që në shekullin e IV e që në Kushtetutën tonë formulohet në trajtën: "E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit." apo, si në kohën e Enver Hoxhës, jeni në shërbim të bandës së plaçkitësve që e shkel përditë kufirin e së drejtës?

Personalisht, kur ma kanë ngritur këtë pyetje jam përgjigjur se me hir dhe me pahir anija e drejtësisë vazhdon të lundrojë në krah dhe jo kundër anijeve të plaçkitësve, pra jashtë kufirit të së drejtës, madje se me përqendrimin gjithnjë e më të madh të pushtetin në duart e Edi Ramës kapërcimi i këtij kufiri po bëhet gjithnjë e më skandaloz. Argumentet e mija i kam shprehur duke ngritur pyetjet:
A do të kishte ndodhur kjo protestë sikur drejtësia të kishte pas bërë punën e vet? J
O, madje edhe vetë ngjarja e Zvërnecit nuk do të kishte ndodhur pasi të dhënat për padrejtësitë e plaçkitësve të përfshirë aty ka vite që janë bërë publike ashtu sikurse edhe natyra kriminale e kësaj qeverie dhe e klientëve të saj.

Po ashtu, sikur të mos e kishte anijen e drejtësisë në anën e vet, a do të guxonte kryeministri të jepte leje grataçielash e resortesh për pastrimin e parave të drogës (sipas projektit Aruba) dhe të sfidonte pastaj protestuesit duke u thënë se është detyra e tyre të provojnë se është ai kumbari?

A do të guxonte ai që, në valën e protestës, të shkelte Kushtetutën duke derdhur 4 milion Euro nga fondi rezervë për të sponsorizuar një antiprotestë? Jo që jo! Prandaj, personalisht, që në ditën e parë të protestës kam bërë thirrje që ajo të drejtohet edhe për nga selia e SPAK-ut.

Mirëpo vë re se ndër protestuesit, veçanërisht të rinjtë, vazhdon të mbizotërojë shpresa dhe besimi se ju do të veproni në emër të së drejtës dhe jo në interes të plaçkitësve.

Do të doja shumë të jem gabim dhe ata të kenë të drejtë. Koha do ta provojë. Megjithatë, duke ju kujtuar se drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar dhe në respekt të shpresës e besimit të tyre, desha t'ju ve në dukje se kjo kohë, që për mua ka kaluar, sot ka ardhur edhe për ta dhe po ulëret.
Momenti historik në të cilin po jetojnë njerëzit e veçanërisht rinia në protestë do të përcaktojë qartë fizionominë ligjore, politike dhe morale të

# PËRSHKALLËZIMI DHE DHUNA, TEORI DHE PRAKTIKË

**ANDI MUSTAFAJ**

Përshkallëzimi dhe dhuna, teori dhe praktikë

Cila është lidhja midis përshkallëzimit dhe dhunës? Përgjigja ndaj kësaj pyetje është kthyer në mollë sherri brenda protestës duke rrezikuar suksesin e saj. Përshkallëzim do të thotë rritje graduale e intensitetit të veprimeve. Nuk do të thotë kalim nga një ekstrem në tjetrin. Është shkallë, jo humnerë.

Deri dje protesta ishte në pikën më të ulët të kësaj shkalle: formë festive, me fëmijë që vizatonin, me muzikë, me fjalime, me ecje paqësore.

Në skajin tjetër të shkallës gjendet ushtrimi i dhunës. Përshkallëzimi nuk do të thotë të hidhesh nga njëra në tjetrën. Do të thotë të ecësh nga njëra drejt tjetrës, hap pas hapi, duke testuar në çdo shkallë nëse veprimi ka qenë i mjaftueshëm për të arritur qëllimin.

Dhuna, në këtë skemë, është momenti i intensitetit më të lartë. Dhe pikërisht sepse është skaji ekstrem, ajo duhet t'i nënshtrohet dy kushteve rigoroze.

E para: të jetë e nevojshme, domethënë çdo shkallë tjetër më e ulët të jetë provuar dhe të ketë dështuar. E dyta, dhe kjo është kushti themelor: masa qytetare e protestës duhet të vlerësojë se përfaqëson vërtet shumicën, dhe se kjo shumicë nuk dëgjohet nga titullarët e institucioneve publike.

Këtu qëndron thelbi filozofik i çështjes. Funksionarët publikë ushtrojnë detyra të deleguara nga sovrani, nga populli. Kur ky delegim shkelet, kur zëri i shumicës injorohet sistematikisht, masa qytetare ka të drejtën t'i rimarrë ato që i ka deleguar.

Kjo është rikthimi i pushtetit politik atje ku i takon prej fillimit.

Por përshkallëzimi nuk është vendim i marrë në një moment euforie. Është strategji, dhe si çdo strategji, kërkon identifikimin e qartë të mjeteve që masa qytetare disponon për të rritur trysninë ndaj shtetit dhe për ta detyruar atë të ndryshojë.

Këto mjete janë të shumëfishta. Për-



shkallëzim do të thotë të mendosh njëkohësisht disa strategji paralele: një drejt vetë pushtetit, për ta bërë të ndjejë peshën e kërkesës. Një për të rritur mbështetjen e opinionit publik, sepse fuqia e protestës rritet kur bindja e saj përhapet.

Një për të ngritur ndërgjegjësimin e bashkësisë ndërkombëtare, që sheh dhe gjykon. Një për të tërhequr mbështetjen e trupave të ndërmjetëm, atyre strukturave, institucioneve dhe individëve që sot qëndrojnë ende brenda sistemit por që mund të zgjedhin anën e drejtë.

Përshkallëzimi përfshin gjithashtu mjete jo të dhunshme si ngadalësimi i veprimtarisë ekonomike ose pengimi i funksionimit normal të shtetit, forma presioni që rëndojnë mbi regjimin pa kërkuar një grimë dhune.

E kam trajtuar këtë në shkrimet e mëparshme dhe nuk dua t'u kthehem këtu: gjithçka funksionon vetëm nëse bashkon sa më shumë njerëz, në mënyrë që secili të gjejë vendin e vet brenda protestës.

Vetëm duke e mishëruar atë me qëllime konkrete, duke rritur besueshmërinë e saj hap pas hapi, dhe duke ndërtuar objektiva politike vërtet të arritshme nga vetë masa qytetare, jo lista dëshirash pa lidhje me realitetin e forcave në lojë.

Përshkallëzimi i kuptuar drejt nuk është thirrje për dhunë. Është thirrje për strategji, për durim taktik, dhe për besim se çdo shkallë e ngjitur me kujdes e afron protestën me qëllimin e saj pa e djegur veten në skajin e gabuar të rrugës.

# Dotech.uk

# BEJENI BIZNESIN TUAJ ME TE DUKSHEM

Porosisni banner profesional
për biznesin tuaj.




**NA KONTAKTONI:**

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

www.dotech.uk

## PVC BANNERS




- Material i fortë PVC
- Printim me cilësi të lartë
- I papërshkueshëm nga uji
- Ideal për ambiente të brendshme dhe të jashtme

## MESH BANNERS




- Material rrjetë (mesh)
- Lejon kalimin e erës
- I qëndrueshëm në çdo mot
- Ideal për ambiente të jashtme dhe skela

## PREMIUM ROLLER




- Dizajn elegant dhe modern
- Printim me cilësi premium
- Stabilitet maksimal
- I përshtatshëm për çdo ambient

## PULL UP ROLLER




- Lehtë për t'u transportuar
- Montim i shpejtë dhe i lehtë
- I përshtatshëm për çdo event
- Praktik dhe i qëndrueshëm

**MATERIALE PREMIUM**
Të qëndrueshme dhe afatgjata.

**PRINTIM ME CILËSI TË LARTË**
Ngjyra të gjalla, detaje perfekte.

**REZISTENT NDAJ MOTIT**
Diell, shi, erë – pa problem!

**PËRGATITJE E SHPEJTË**
Porosit sot, merr shpejt!

## RRITNI DUKSHMËRINË. ZHVILLONI BIZNESIN TUAJ.

**TËRHIQNI AUDIENCËN TUAJ.**
Rritni interesin dhe besimin.

**REZULTATE QË FUNKSIONOJNË.**
Zgjidhje që sjellin rezultate reale.

**BËNI NJË HAP PËRPARA.**
Ne jemi këtu për ju.

www.dotech.uk

info@dotech.uk

# BIRN: QINDRA PROFILE TË RREME TARGETOJNË MBËSHTETËSIT E PROTESTËS



Ndërsa kryeministri Edi Rama akuzoi publikisht algoritmin e rrjeteve sociale për nxitje të protestave, të dhënat e siguruara nga BIRN tregojnë se qindra profile të rreme janë hapur së fundmi për të shpërndarë njëherazi propagandë qeveritare dhe mesazhe të koordinuara kundër mbështetësve të protestës.

Ish-drejtori i Teatrit Kombëtar, Hervin Çuli riktheu në vëmendje përmes një statusi në Facebook më 14 korrik një konflikt të dikurshëm me ish-ministren e Kulturës për atë që ai e quajti "algoritmi fake".

Në kohën kur ishte në detyrë, Çuli thotë se i ishte kërkuar që të shpërndante dhe të pëlqente postimet e Ministrisë dhe institucioneve të varësisë në rrjetet sociale – një praktikë e gjithëpërhapur mes administratës publike, të cilën ai e konsideroi "sakrificë të përditshme profesionale për një like më tepër".

Sipas tij, ish-ministja Elva Margariti ia kishte prezantuar kërkesën si porosi të kryeministrit.

Regjisori dhe aktori Hervin Çuli e drejtoi Teatrin Kombëtar për dy mandate gjatë viteve 2014-2022, por beteja e qeverisë për të dominuar rrjetet sociale nuk duket se ka ndryshuar.

"Skema ishte e thjeshtë," shpjegoi Çuli në një bisedë telefonike për BIRN.

"U krijua një grup Whatsapp-i me të gjithë drejtorët e ministrisë së Kulturës dhe aty duhej të shpërndanin aktivitetet dhe të shpërndanin atë që postohej," shtoi ai, duke theksuar se kjo u përcillej edhe vartësve. "Aty bëheshin postimet dhe duhej t'i shpërndaje dhe pëlqeje".

I gjendur prej 50 ditësh përballë protestave maratonë që kërkojnë dorëheqjen e tij, kryeministri Edi Rama akuzoi mes të tjerash edhe algoritmin e rrjeteve sociale se i ka hedhur "benzinë zjarrit" të revoltës qytetare.

"Sa më shumë shikueshmëri, aq më shumë ndikim. Sa më shumë ndikim, aq më shumë pushtet. Mbi kë? Mbi skllevërit e algoritmeve, mbi të gjithë ne," deklaroi Rama në një mbledhje me grupin parlamentar të PS.

Por të dhënat e siguruara nga BIRN sugjerojnë se gjatë ditëve të nxehta të protestave, platformat e rrjeteve sociale u përmbytën nga qindra llogari të rreme, të cilat shpërndajnë njëherazi propagandën qeveritare si dhe sulme të koordinuara ndaj mbështetësve të protestës.

Mekanizmi është thuajse identik me atë që përdor administrata publike, ku videot e përgatitura nga zyrat e PR-it të qeverisë dhe memet e gatshme shpërndahen njëkohësisht nga një ushtri dixhitale e fshehur pas profileve fantazmë.

Sipas ekspertëve të teknologjisë së informacionit, kjo teknikë përdoret për të krijuar idenë e rreme të një mbështetjeje publike, po aq sa për të sulmuar kundërshtarët.

"Kur veprojnë në numër të madh dhe në mënyrë të sinkronizuar, algoritmet e rrjeteve sociale mund ta interpretojnë këtë aktivitet si interes organik, duke i dhënë përmbajtjes më shumë shtrirje," tha Besmir Semanaj, ekspert IT.

Zyra e shtypit e kryeministrit mohoi lidhjen mes profileve të rreme dhe punonjësve të administratës.

"Nuk ka asnjë urdhër a koordinim të administratës për këtë gjë nga qeveria, madje qeveria e konsideron absurd këtë pretendim," tha një këshilltare për mediat e kryeministrit. Ish-ministrja e Kulturës, Elva Margariti, refuzoi të komentonte mbi statusin e Hervin Çulit.

Propagandë dhe fushatë denigruese

Teknika e shpërndarjes masive të përmbajtjes nga shumë aktorë njëkohësisht njihet nga studiuesit si "sjelljes joautentike e koordinuar".

Në një publikim të vitit 2025 në Sage Journals, studiuesit Richard Rogers dhe Nicola Righetti theksojnë se qëllimi kryesor i kësaj sjelljeje është gënjimi i algoritmeve që përdorin rrjetet sociale, përmes imitimit të "angazhimit organik".

Kjo nuk është diçka e re në Shqipëri. Gjatë fushatës së fundit elektorale, qindra profile që përfundonin në mënyrë unike ".2025" u përdorën për të komentuar apo sulmuar kandidatë të ndryshëm. Njësoj si në kohë zgjedhjesh, qindra profile të rreme janë hedhur në hapësirat virtuale të rrjeteve sociale, duke targetuar këtë herë protestën.

BIRN identifikoi mbi 100 profile të rreme në Facebook dhe Instagram, të krijuara mes datave 28-30 qershor. Një pjesë e madhe e tyre u identifikuan duke monitoruar manualisht postimet e kryeministrit në Facebook dhe personat që i kishin shpërndarë ato.

Profilet nuk e fshehin përkatësinë, pasi përdorin kryesisht si pseudonim emra qytetesh dhe lidhje direkte me Partinë Socialiste, të tilla si "Edi Rama per Shqiperine 2030", "kolonjasot2030" apo "Bulqiza e së Ardhmes 2030".

Edhe pse kanë emra të ndryshëm, profilet shpërndajnë përmbajtje të njëjtë propagandistike. Por ndryshe nga profilet reale që shpërndajnë kryesisht postime pozitive në favor të qeverisë, profilet e rreme përdoren masivisht për të sulmuar apo delegjitimuar protestën apo mbështetës të saj.

Të targetuar janë kryesisht drejtuesit e partive të vogla parlamentare, Agron Shehaj dhe Arlind Qorri, personazhe që kanë treguar protagonizëm në protestë dhe deri te këngëtarja Dua Lipa, e cila mbajti së fundmi një qëndrim pro protestës që zhvillohet prej fillimit të qershorit në Tiranë.

Postimet në këto faqe, memet apo fotomontazhet janë shpesh identike nga njëri profil në tjetrin. Por edhe pse duket se ato nuk marrin fare vëmendje, kjo nuk i bën të padëmshme.

Deputetja Marjana Koçeku i tha BIRN se u përball me një fushatë të egër denigruese online, pasi deklaroi se po shkëputej nga Partia Socialiste për shkak të protestave.

"Ishin profile të reja dhe përdornin gjuhë denigruese e fyese. I kam ruajtur të gjitha, zgjati disa ditë," tha Koçeku për BIRN.

Edhe aktivistja Sidorela Vatnikaj e gjeti veten të targetuar online për shkak të angazhimit të saj në protestë, përmes sulmeve masive të dirigjuara nga profile false apo nga profile reale militantësh partiakë.

"Këta kryesisht synojnë të shajnë individin, të thonë 'je e Sorosit' etj. Pati një rast që më përmendën edhe partnerin," thotë Vatnikaj, duke theksuar se gjatë sulmeve përdoret shpesh gjuhë diskriminuese krahinore, me etiketime si "maloke" apo të "dhunshme".

Patronazhimi dixhital

Ish-zyrtarë të administratës publike i thanë BIRN se mazhoranca qeverisëse përdor prej vitesh një makineri dixhitale që mirëmbahet përmes një strukture monitorimi dhe ka në krye një "Koordinator Dixhital".

Sipas tyre, mekanizmi ushqehet nga produktet e prodhuara nga zyrat e PR-it dhe përfshin pothuajse të githa degët e administratës, përmes linjave hierarkike që justifikoheshin me pretekstin e transparencës, por që ishin thellësisht kontrolluese.

Një ish-zyrtare e qeverisjes qendrore i tha BIRN se kishte qenë pjesë e grupeve të WhatsApp-it ku hidheshin postimet dhe gjithçka monitorohej.

"U punësuan njerëz konkretë për këtë, vajza me çanta Chanel, që nuk bënin asgjë tjetër. Çdo gjë kontrollohej normalisht dhe kishin një sistem për vlerësim," tha ajo në kushtet e anonimatit.

Kjo praktikë konfirmohet edhe nga një tjetër ish-punonjëse në nivele më të ulëta të administratës, e cila thekson se në këto grupe hidheshin postimet që duhej të shpërndaheshin në profilet e tyre në rrjetet sociale dhe të pëlqeheshin me detyrim, sidomos gjatë fushatës.

"Nëse një person në grup nuk ishte aktiv mjaftueshëm, i tërhiqej vëmendja me mesazhe të tipit 'nuk je aktiv'," thotë ajo, duke shtuar se çdo ndërveprim shënohej me përpikëri dhe kishte një sistem vlerësimi.

Ish-zyrtarët i thanë BIRN se për të identifikuar personat që ishin pjesë e këtij sistemi patronazhimi dixhital, mjafton të ndjekësh se kush i pëlqen dhe i shpërndan postimet e një X ministri të caktuar.

"Dallojnë se në këto profile, edhe pse reale, nuk ka asgjë personale, por vetëm ndarje postimesh politike," tha një prej tyre.

"Është më e lehtë në faqet e personazheve publikë që kanë më pak shpërndarje," na sugjeroi një tjetër ish-funksionar.

Këto shpjegime e çuan BIRN të identifikonte më shumë profile të rreme të krijuara në fund të qershorit, sikurse edhe një numër personash të punësuar në administratë që ndanin dhe pëlqenin qëndrimet politike të përfaqësuesve të shumicës, përfshirë edhe qëndrimet kundër protestës.

Për shembull, një postim i ish-zv. kryeministres Belinda Balluku, që krahasonte protestën e fundit me sulmin ndaj kryeministrisë në vitin 1998, u nda nga një numër punonjësish të administratës publike, bashkive apo kompanive publike në Fier, Patos dhe Lushnjë.

Në ndjekje e këtyre profileve, pas të cilave ka persona realë, vëren gjithashtu se ata nuk ndajnë vetëm përmbajtje politike, por edhe videot e perëndimit të diellit në det, të postuara nga Balluku.

(Reporter)

# EKONOMIA E QELESHES DHE EKONOMISTËT E POTUREVE

**SONILA MEÇO**

"Me çfarë do bëni mirëqenie, duke shitur qeleshe dhe flamuj?", pyeti kryeministri shqiptarët shumë i revoltuar se nuk po ia çmojnë betonizimin e çdo centimetri katror edhe në bregdet.

Më kujtoi batutën tek "Prefekti", kur regjimi tallej me një figurë të nderuar historike, duke i vënë në gojë batuta të sajuara: "Me ça do ta luftoni faÇizmin ju, me ibrikun e salepit apo kokrrën e morrit që ma keni sa nji kokërr orizi?!".

Pasi e bëri lanet popullin mosmirënjohës me qeleshe, që s'di të kuptojë "talentin" e tij ekonomik e financiar, kryeministri shpalosi ca shifra allasoj se turizmi, investimet e huaja dhe remitancat kanë sjellë begatinë e lekut dhe telendisjen e euros.

O kryeministër me poture, ne populli me qeleshe po te kujtojmë se forcimi i një monedhe nuk është certifikata e shëndetit ekonomik! "Leku është forcuar, pra ekonomia është e fortë.", thoshte plot qesëndi karshi atyre që po vuajnë çdo ditë pasojat e rritjes së lekut në ekonomi të rrënuar.

Kryeministri e di mirë nga forcohet leku. Problemi është se përpiqet të na bindë se eurot e futura janë të gjitha njëlloj. Ekonomia, kur numëron valutën, nuk pyet nëse euroja ka ardhur nga një fabrikë, nga një hotel apo nga një kartel kokaine.

Pyetja që bën çdo ekonomist me qeleshe nuk është a po forcohet leku, por se cila është struktura e flukseve të euros, që po e forcojnë.

Çdo euro nuk ka të njëjtën cilësi ekonomike. Për shembull, një euro e krijuar nga eksporti është krejt tjetër prej një euroje ardhur nga shitja e një apartamenti, nga remitancat, nga turizmi sezonal dhe krejt tjetër nga një euro që hyn në ekonomi përmes kanaleve kriminale dhe pastrohet në pasuri të paluajtshme.

Tregu valutor nuk bën hiç dallim moral. S'pyet fare nga erdhi euroja, nuk ka sensor etik.

Por ti si kryeministër i vendit e ke për detyrë t'i përgjigjesh popullit me qeleshe, sepse ndërsa feston lekun e fortë, ata të paktë që ende prodhojnë në Shqipëri po marrin goditjen më të madhe.

Eksportuesit marrin më pak lekë për të njëjtën euro, humbasin konkurrueshmërinë, mbyllin linja prodhimi dhe largojnë punëtorë. Pra, nëse ky është "sukses", ai po matet me falimentimin e atyre që ende prodhojnë.

Defiçiti tregtar qëndron stoik, ku importet i marrin frymën eksporteve duke varfëruar shqiptarët me qeleshe, sepse një vend bëhet i pasur veç kur prodhon më shumë sesa konsumon.

Atëherë si shpjegohet një ofertë kaq e



madhe eurosh në një ekonomi që nuk prodhon, ka deficit kronik tregtar, investime të huaja modeste kryesisht nga fitimet e riinvestuara dhe eksporte që nuk mbështesin këtë forcim? Turizmi, remitancat dhe investimet nuk mjaftojnë, madje me logjikën e 8,5 miliardë eurove hyrje duhej që euro të qe më e fortë.

Atëherë ekonomistët me qeleshe e logjikë, e gjejnë përgjigjen tek flukset e kapitalit nga aktivitetet e pastrimit të parave. Dosje si "Aruba", të Sky ECC apo EncroChat përshkruajnë hyrje të mëdha kapitali kriminal dhe mekanizma të investimit të tyre në ekonomi.

Çdo ekonomist me qeleshe (jo poture) e di se kapitali kriminal, nëse riciklohet brenda vendit, rrit ofertën e valutës duke e zhvlerësuar euron në vlera historike.

Pra, një monedhë nuk bëhet simbol i suksesit vetëm sepse forcohet. Ekonomisë nuk i skuqen faqet nga shëndeti se kursi tregon forcimin e lekut, por nga koherenca e gjithë sistemit. Kur prodhimi dobësohet, eksportet mpaken dhe ekonomia mbështetet gjithnjë e më shumë tek flukset jo produktive me origjinë kriminale e korruptive, atëherë leku i forcuar është hall për shqiptarët. Hall i madh.

Një vend bëhet i pasur kur prodhon, kur shpik, eksporton. Kur krijon vlerë të shtuar. Kur një inxhinier, një fermer, një fabrikë, një laborator apo një startup vlejnë më shumë se një kontratë shitjeje toke, brigjesh, malesh, lagunash, pyjesh, qytetesh.

Ironia zeher është se kryeministri tallet me qeleshen, ndërsa industria që ka lulëzuar në këto vite është ajo e betonit dhe shitjes së pasurisë publike. Një qeleshe, të paktën, është produkt.

Dikush e punon, dikush fiton prej saj. Dikush mund ta eksportojë. Ka mjeshtra, ka punë, ka zinxhir vlere, ka identitet.
Ndaj nuk mund të përçmohet kaq paturpësisht nga kryeministri i shqiptarëve që mat ekonominë tek dera e exchange-it.

Tregu valutor nuk pyet nëse euro ka ardhur nga një fabrikë në Korçë, nga një turist në Ksamil, nga një agroturizem ne Theth, nga minierat në Bulqizë, apo vilat e shitura në zona të mbrojtura, nga skemat e pastrimit të parave, nga bananet e Ekuadorit dhe projektet e Albanian Files.

Ndaj jam me ekonominë e qeleshes. Sepse çdo ekonomi që përçmon prodhimin, përfundon duke shitur…edhe poturet.

# SHQIPËRIA, MË SHUMË FAMË NGA FLAMINGOT SE NGA NJË KËNGËTAR URREJTJENXITËS

**ARBEN MALAJ**

Fama globale?

Nuk jemi në epokën e gurit. Ndoshta të mbretërve kryeministrorë, po.

Jemi në periudhën e Inteligjencës Artificiale, ku në milionat e sekondës dhe me shume pak lekë mund të arrish çdo cep të botës dhe çdo individ të botës globale për mirë apo për keq.

Ti jeton në "Kopshtin e Edenit" si faraonët e mijëra shekujve më parë. Ti jeton në kullën e fildishtë të arrogancës dhe të urrejtjes ndaj popullit tënd.

Jemi vendi i fundit në Evropë në testimin PISA.

Pra, të fundit për cilësinë e arsimit. Jemi të parët për koston e lartë të pagesës nga xhepi të faturave shëndetësore, me rreth 65% të shumës së çmimeve të ilaçeve.

Jemi të fundit për sigurimin e ujit të pijshëm në qytete dhe fshatra. Jemi të parët në pamundësinë e blerjes së shtëpisë së parë.

Sepse ti ndoqe modelin: Shqipëria sa më e shtrenjtë dhe shqiptarët më të varfër. Jemi të fundit në garantimin dhe gëzimin e pronës private.



Jemi të parët të ndëshkuar nga drejtësia e mohuar. Jemi të fundit jo vetëm në Evropë, ku: (i) drejtësia vonohet deri në 21 vite dhe (ii) stoku dosjeve të pashqyrtuara janë rreth 200 mijë. Para pak ditëve rezultuam të parët ne Evrope ku të rinjtë dëshirojnë të braktisin vendin e tyre.

Përqindja ishte (i) tronditëse, (ii) shpirtërisht dërmuese, (iii) ekonomikisht vrastare për ekzistencën tone në të ardhmen, jo shumë të largët. Janë mbi 67% e të rinjve që duan ta braktisin vendin e tyre. Jemi në shekullin e 21, në shekullin ku fama nuk blihet, po fitohet. Më shumë "famë" Shqipëria ka marrë nga "flamingot" sesa nga një këngëtar; (i) 400 milionë dollarë pasuri (ii) bipolar, (iii) urrejtjenxitës dhe (Iv) kontravers.

Të cilin e braktisën kompanitë më të mëdha sponsorizuese si 'Adidas' për nxitjen e antisemitizmit dhe lartësimin e Hitlerit.

Po pse nuk promovohet Shqipëria nëpërmjet Dua Lipës dhe talenteve të tjera me famë botërore nga trojet shqiptare? Ti nuk financove këngëtarin, ti financove organizatorët.

Babëzia jote për pushtet, deri kriminale, nuk ka kufi: (i) etik, (ii) moral, (iii) shoqëror, (iv) përgjegjësi buxhetore, (v) papërgjegjshmëri politike. Koha është gjykatësi më i madh! Kujdes nga mallkimi me shpirt i njerëzve të varfër të vendit tonë!

# ATA QË E KAPIN DITËN DHE ATA QË E SHESIN BREGDETIN!



**KIM MEHMETI**

Shumica e pushuesve në Velipojë janë të moshuar.

Janë nga ata që zgjohen para se të lindë dielli, sepse duan ta 'kapin' ditën!
Këtu më të rrallë janë të rinjtë që nuk i tremben perëndimit të diellit dhe që bien në gjumë vonë, pas mesnate; pra, ata që e kanë kapur jetën.

Mëngjeset në Velipojë të mundësojnë t'i shohësh vendasit teksa bëhen gati të shesin gjithçka, përfshirë edhe mirësjelljen e tyre, por jo edhe atë që as shitet e as blihet – të të çmojnë për atë që je dhe atë që ke!
Dhe ata, më mirë se kushdo tjetër, e kanë kuptuar se Shqipëria duhet të bëjë çmos për të tërhequr pushues të huaj, por se nuk të vlen shumë turizmi nëse bregdeti shqiptar mbetet pa pushuest 'varfanjakë' si vetvetja, pa ata që e duan Kuq e Zinë shqiptare dhe që vijnë këtu, o për ta kapur ditën, o për ta mbajtur në duar jetën.

Prandaj, në Velipojë, më mirë se kudo tjetër, e kupton pse shqiptarët janë aq të ndjeshëm kur ua shesin bregdetin.
Në përgjithësi, në Velipojë nuk i kalojnë pushimet ata që pasurohen duke e shitur bregdetin shqiptar e as djemtë me makina të shtrenjta, të blera nga baballarët e tyre të pasur.
Këtu nuk vijnë të pushojnë as bukuroshet e 'Dubait' - vajzat e pasura që në trup kanë më shumë silikon e botoks sesa muskuj dhe të cilave, si të tilla, as nënat e tyre nuk ua kujtojnë më pamjen e natyrshme.
Shumica e pushuesve të Velipojës janë baballarë që mbikëqyrin fëmijët e tyre të vegjël dhe djem që kujdesen për prindërit e tyre të moshuar.
Këtu pushojnë edhe vajzat që mbajnë për dore nënat e tyre të moshuara, që kujdesen për gjyshet e veta të cilat nuk i freskon gjithaq uji i detit, por kujdesi dhe dashuria e pasardhësve të tyre.
Po, në Velipojë ka më shumë njerëz që i gëzohen lindjes së diellit sesa të rinj që i gëzohen perëndimit të tij.

Por, sidoqoftë, të gjithë e kanë kuptuar se, nga do që ta kthesh, dielli lind në Lindje dhe perëndon në Perëndim.
Siç e kanë kuptuar edhe se nuk ka njeri që mund të përcaktojë saktë se kur është dielli më i bukur: kur lind apo kur perëndon.
Ashtu siç nuk e dine njeri se si e përjetojnë bukurinë mahnitëse të Velipojës ata që duan ta kapin ditën, e si ata që e kanë kapur jetën.

# PAS "PAKETËS SË CUBAVE", RAMA NË THETH ME "PAKETËN E MALEVE"

**ALFRED LELA**



Një sezon pasi ua hodhi në tokë edhe bujtinat që kishin ndërtuar, edhe fjalën që u kishte dhënë, Edi Rama u ngjit në Theth, fshatin që ende lëpin plagët e sulmit të organizuar nga po ky kryeministër. Shumë gjëra kanë ndryshuar që atëherë, megjithatë.

Rama që përmbysi djersën dhe bereqetin e dhjetra familjeve thethjane, me fadroma e buldozerë, tani e sheh fatin e tij të stërkeqet përballë një vale protestash që po hyjnë ngadalë në muajin e dytë: flamingot e Nartës duken se po marrin hakun e shqiponjave të Thethit.

Rama nuk ka në krah as Marjana Koçekun, deputeten e zonës, e cila është bijë Shale (Thethi i përket bajrakut të Shalës), e neveritur me sa duket nga qëndrimi i tij për Nartën, një pakënaqësi që, të paktën sipas asaj vetë, ka nisur që me Thethin para një viti.

Përfaqësuesen e zones, Rama e kishte zëvendësuar me United Colors of Benneton, duke filluar me Benetin e becajve dhe ndonjë shtegtar tjetër, që fliste si nga Thethi, meqë gruan e kishte prej atij fshati.

Kush lexon nga pak histori, skendat e djeshme të Ramës në Theth, duhet t'i jenë përngarë me zyrtarët komunistë të pas 46-ës, që ngjiteshin në ato anë për të regjistruar popullsinë (për ta patronazhuar më saktë). Një ndjesi superioriteti (apo neverie) ndaj malësorëve, e shprehnin edhe duke ua ndërruar mbiemrat stërgjyshorë dhe katolikë, dhe duke ua zëvendësuar me toponime apoq qesëndi, që të dërguarve të partisë u vinin në mend aty për aty.

Rama dhe Beneti dukeshin dje si komunistër e rilindur, 2.0, të 46-ës që medemek kishin dalë për ta rregulluar Thethin, por gjasat janë që ta shtrembërojnë për herë të fundit atë fshat, që duket sikur Zoti e ka hedhur në atë luginë, si të ishte pëllëmba e dorës së Tij, për të pasqyruar veten në botë dhe jo për të pasqyruar botën (aq më pak atë të Ramës e Becit).

Në këtë kuptim, Rama kryen edhe një tradhti finale ndaj Veriut. Ai u hedh te këmbët "Paketën e maleve", e cila përveçse është e diskutueshme për qëllimet, mund të jetë e dëmshme për pretendimet. Veriu, edhe pse- duhet pranuar, me toka më të pakta, ka qenë treva e vetme pa konflikte për kufijtë, tokat, kullotat, dhe kjo për arsye që lidhen me traditën.

Secili banor, apo familje, e ka ruajtur brez pas brezi, jo në letra por në kujtesë, tokën e vet dhe të tjetrit, dhe ky mirëkuptim ka prodhuar atë paqe sociale. "Paketa e maleve" mund të hapë një konflikt të panjohur për këto zona, mund të transferojë në malet e Shqipërisë atë batërdi, moskuptim dhe hajdutëri që gjithë këto vite ka përshkruar Ultësirën Perëndimore dhe bregdetin.

Kjo mund të jetë dhurata e fundit e Edi Ramës për Veriun, ndër shumë të tilla, të hidhura, të tij që në vitin 2013. Me këtë Rama mund të çojë në kriminalizimin e dytë të Veriut. Pas "Paketës së Cubave", mbushjen e Kuvendit me banditët e Gegnisë, nga Kruja deri në kufi, ai propozon "Paketën e maleve", hapjen e një kutie Pandore, e një konflikti të paqenë deri sot.

Kush ka lexuar raportet e misionit Jezuit në Shqipëri në fund të shekullit '19-të dhe nisje të të 20-tit, mund të gjejë te Rama të njëjtën sjellje me atë të qeveritarëve osmanë në raport me zonat katolike në Shqipëri.

Sigurisht, për Edi Ramën, nuk mund të themi se është turk, duke qenë se ai vetë paraqitet si shumë gjëra dhe, njëkohësisht si asgjë.

Akoma nuk keni një website?
Akoma nuk jeni regjistruar në Google
Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona
Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545

# DY MINISTRA TË SERBISË DHE ANALOGJIA QË EVROPA SHMANG

VETON SURROI

**Paunoviq dhe Daçiq rikthyen logjikën etnoterritoriale të "Blut und Boden": Kosova shpallet tokë serbe për shkak të gjakut, varreve dhe monumenteve serbe, ndërsa shqiptarët trajtohen si banorë të kushtëzuar, me Shqipërinë si "shtet amë". Në aktgjykimet për Kosovën, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë konstatoi se kjo logjikë u operacionalizua përmes dhunës dhe terrorit, me synim dëbimin me forcë të një pjese të konsiderueshme të shqiptarëve, ndryshimin e përbërjes etnike dhe sigurimin e vazhdimit të kontrollit serb mbi Kosovën**



"Imagjino sikur të kishte ndodhur në Gjermani më 1972..."

Kështu filloi dhe u ndërpre fjalia e një diplomati me të cilin bisedonim rreth deklaratës tashmë të famshme të ministres së Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale të Serbisë Snezhana Paunoviq, deklaratës së saj në mbështetje të spastrimit etnik të shqiptarëve.

Ndërprerja ishte një vetëpërmbajtje e edukatës evropiane. Vazhdimi mund të paramendohej: "...dhe një ministre të shprehte, 27 vjet pas luftës, keqardhje pse nuk u spastruan të gjithë hebrenjtë". Por kjo do të çonte drejt një analogjie të papërpjesëtueshme. Analogjia me Holokaustin nuk mund të vlejë për përmasën, mekanizmin apo natyrën e krimit. Megjithatë, ajo vlen vetëm për pyetjen politike: çfarë do të ndodhte në një demokraci të pasluftës sikur një ministre ta paraqiste dëbimin e një popullsie si politikë që duhej zbatuar?

Është e vështirë të gjendet në Evropën tetëdhjetenjëvjeçare të pas Luftës së Dytë Botërore një rast i krahasueshëm: një ministër i zgjedhur në garë shumëpartiake që shpreh keqardhje pse spastrimi etnik nuk është përmbushur plotësisht. Aq më pak në Gjermani, një shoqëri që ka prirë në ballafaqimin me të kaluarën.

2.

Ndoshta mungesa e analogjisë mund të ketë ndikuar në dy reagimet e para të BE-së. Zëdhënësja e BE-së tha se "në Evropë nuk ka vend për retorikë që arsyeton ose përkrah spastrimin etnik", ndërsa komisionerja Marta Kos deklaroi se "ishte e tmerrshme të dëgjohej diçka e tillë në vitin 2026" dhe shtoi se nuk mund ta përfytyronte që një ministre të vazhdonte detyrën pas një deklarate të tillë.
Por mungesa e analogjisë nuk ndihmon në rrugën e mëtejme. Konstatimi se "në Evropë nuk ka vend për retorikë që arsyeton ose përkrah spastrimin etnik" shpreh një normë, por bie ndesh me realitetin institucional: bartësit e kësaj retorike vazhdojnë të kenë vend në qeverinë e një shteti kandidat për anëtarësim.
Paunoviq jo vetëm e arsyetoi spastrimin etnik, por tregoi se si do ta bënte. Presidenti Aleksandar Vuçiq u distancua verbalisht, duke thënë se politika shtetërore është paqja dhe jo spastrimi etnik. Por distancimi nuk prodhoi pasoja institucionale: Paunoviq vazhdoi detyrën, ndërsa ministri i Punëve të Brendshme dhe shefi i saj partiak, Ivica Daçiq, e mbrojti publikisht — posaçërisht logjikën se njerëzit që "nuk e ndiejnë Serbinë si shtet të vetin" duhet të largohen dhe të shkojnë në "shtetin e tyre amë".

Një prej ideve prijëse të nacionalizmit serb karshi Kosovës, nga fundi i shekullit XIX deri më sot, është ajo e një hapësire etnike serbe në të cilën shqiptarët trajtohen si trup i huaj.

Dhe këtu analogjitë teprojnë. Shekulli XX dhe ky në të cilin jetojmë janë përplot me luftëra, dëbime, vrasje dhe gjenocide të mbështetura në idenë se një komunitet kombëtar a fetar është i huaj në "tokën e shenjtë të kombit të zgjedhur".

3.

Dy ministra të Qeverisë së Serbisë përsëritën si të mirëqenë logjikën e "Blut und Boden"(gjakut dhe dheut): Kosova paraqitet si tokë serbe për shkak të gjakut, varreve dhe monumenteve serbe, ndërsa shqiptarët që jetojnë në të shpallen banorë të kushtëzuar, me Shqipërinë si atdheun e tyre të supozuar. Analogjia nuk nënkupton se regjimet apo krimet janë historikisht identike; ajo i referohet strukturës së argumentit — gjaku përdoret si titull pronësie mbi tokën, ndërsa popullsia tjetër trajtohet si e huaj.
Krimet përmes të cilave u zbatua projekti i homogjenizimit etnik kanë marrë kualifikim juridik në aktgjykime të formës së prerë: gjenocid në Srebrenicë, ndërsa në çështjet e Kosovës deportim, zhvendosje të detyruar, përndjekje e vrasje në kuadër të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë konstatoi se Shainoviq, Pavkoviq dhe Lukiq morën pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale me synim dëbimin me forcë të popullsisë shqiptare të Kosovës.
Ojdaniq dhe Lazareviq u dënuan për ndihmë dhe nxitje të deportimit dhe zhvendosjes së detyruar. Në çështjen e gjeneralit të policisë Vllastimir Gjorgjeviq u konfirmua një ndërmarrje e përbashkët kriminale me synim ndryshimin e ekuilibrit etnik për të siguruar vazhdimin e kontrollit serb mbi Kosovën.

Dënimet përfshinë, varësisht nga i akuzuari, deportimin, zhvendosjen me forcë, përndjekjen dhe vrasjen. Ky ishte operacionalizimi kriminal i logjikës që sot përsëritet politikisht: se në territorin e Kosovës shqiptarët janë të huaj.

Në këtë kontekst nuk kemi të bëjmë vetëm me rehabilitimin e një ideologjie, por me rivendosjen e pretendimit për legjitimitetin e përndjekjes së shqiptarëve — jo vetëm në kundërshtim me parimet morale, por edhe me normat juridike të afirmuara në aktgjykimet Shainoviq et al. dhe Gjorgjeviq.
Dy ministrat nuk mjaftohen me pohimin se spastrimi etnik duhej bërë më 1998: ata përsërisin sot premisën që do ta legjitimonte atë — se shqiptarët në Kosovë janë element i huaj që duhet të largohet.

4.

Gjërat kanë ndryshuar, natyrisht. Ministrat Paunoviq dhe Daçiq nuk i kanë instrumentet e vitit 1999 për ta zbatuar këtë ide në Kosovë; tash nuk mund ta kalojnë kufirin as individualisht. Problemi qëndron te hendeku ndërmjet nocionit të "evropianizimit" dhe tolerimit institucional të mohimit të krimeve.

Në logjikën e ballafaqimit me të kaluarën, Kosova dhe Serbia tashmë duhej të kishin tejkaluar jo vetëm luftën, por edhe ideologjinë e saj; krimet përmes të cilave ajo u zbatua janë gjykuar në Hagë në çështjet e Srebrenicës, Shainoviqit dhe Gjorgjeviqit.
Në "orën evropiane", 27 vjet do të duhej të mjaftonin për ta bërë politikisht të papranueshme gjuhën e spastrimit. Kosova dhe Serbia nuk do të duhej të ishin ende në një stad marrëdhëniesh ku Serbia mohon të drejtën ekzistenciale të shqiptarëve të Kosovës në emër të një "hapësire etnoterritoriale serbe".

Por megjithatë po ndodh. Përgjigjja e BE-së mbetet performative: përsërit se kjo retorikë nuk ka vend në Evropë, ndërkohë që bartësit e saj vazhdojnë të kenë vend në qeverinë e një shteti kandidat. Në hapësirën politike të zgjerimit të BE-së ka vend për ministrat Paunoviq dhe Daçiq, pjesëtarë të Qeverisë së një vendi që ka punuar aktivisht kundër normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, kundër zbatimit të marrëveshjeve evropiane dhe kundër tërësisë territoriale e sovranitetit të Kosovës — pra edhe kundër sigurisë së qytetarëve të saj.

Kur Serbia, me letrën e rezervimit të dhjetorit 2023, refuzon pjesët e Marrëveshjes së vitit 2023 që nënkuptojnë njohjen de facto të Kosovës, dhe kur përgjigjja shtetërore ndaj sulmit në Banjskë mbetet pa llogaridhënie bindëse, ajo nuk vepron nga një tekë apo shpërthim emocional. Ajo operacionalizon një ide prijëse kolektive, të cilën e mbrojtën publikisht dy ministra të Qeverisë së Beogradit: se shqiptarët janë trup i huaj në "tokën e shenjtë" të Kosovës.

Dhe përballë kësaj, Brukseli zyrtar vazhdon ta përdorë instrumentin e vet të preferuar, keqardhjen.

**EVROPA E LIRË**

# REPUBLIKA SËRPSKA LOBON ME MILIONA NË SHBA PËR PAVARËSINË E SAJ



Republika Sërpska ka shpenzuar katër milionë dollarë nga buxheti i saj për të paguar lobistë në Uashington, që të promovojnë pavarësinë e këtij entiteti nga Bosnje dhe Hercegovina, tregojnë të dhënat e Departamentit amerikan të Drejtësisë, të analizuara nga Radio Evropa e Lirë.

Kontrata e fundit me kompaninë izraelito-kanadeze Dickens & Madson është vetëm pjesë e një fushate shumëvjeçare lobimi që autoritetet e Republikës Sërpska zhvillojnë në Shtetet e Bashkuara.
Që nga viti 2015, për këtë qëllim janë shpenzuar të paktën 8.3 milionë dollarë.
Objektivat e lobimit kanë përfshirë, mes tjerash, heqjen e sanksioneve amerikane ndaj ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, si dhe sfidimin e legjitimitetit të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar në Bosnje dhe Hercegovinë, Christian Schmidt.
Shtetet e Bashkuara i hoqën sanksionet ndaj Dodikut dhe bashkëpunëtorëve të tij në vitin 2025, ndërsa Schmidt dha dorëheqje në maj të këtij viti.
Nga rishikimi i buxhetit për vitin 2025, autoritetet e Republikës Sërpska ndanë edhe 54.9 milionë marka konvertibile, apo rreth 28 milionë euro, për aktivitete lobuese.
Këto mjete u miratuan nga shumica qeverisëse në Kuvendin Popullor të Republikës Sërpska, i udhëhequr nga Aleanca e Socialdemokratëve të Pavarur (SNSD) e Millorad Dodikut.
Në anën tjetër, institucionet shtetërore të Bosnje dhe Hercegovinës kanë angazhuar vetëm një herë një kompani lobuese që nga përfundimi i luftës në vitin 1995.
Kjo ka ndodhur vitin e kaluar, kur për dhjetë muaj është kontraktuar një firmë për të mbrojtur integritetin territorial të shtetit.
Ari Ben-Menashe, ish-oficer i inteligjencës ushtarake izraelite dhe themelues i kompanisë Dickens & Madson, refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve të Radios Evropa e Lirë nëse pavarësia e Republikës Sërpska mbetet ende objektivi i angazhimit të kompanisë dhe si synon ajo ta promovojë këtë politikë para institucioneve amerikane dhe ndërkombëtare.
"Nuk mund t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve për shkak të detyrimeve të konfidencialitetit që rrjedhin nga kontrata", tha Ben-Menashe në një përgjigje me shkrim për Radion Evropa e Lirë.
Pyetjeve nuk iu përgjigjën as Qeveria e Republikës Sërpska, e cila nënshkroi kontratën me Ben-Menashen në shtator të vitit 2025, dhe as Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnje dhe Hercegovinës, e cila në fillim të vitit 2025 kishte angazhuar për një periudhë të shkurtër lobistë për të mbrojtur integritetin territorial të Bosnje dhe Hercegovinës dhe interesat që i kundërshtojnë ato të autoriteteve të Republikës Sërpska.
Sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Bosnje dhe Hercegovinës, entitetet nuk kanë të drejtë të shkëputen nga shteti, përfshirë edhe organizimin e referendumit për një çështje të tillë, edhe pse autoritetet e Republikës Sërpska e kanë përmendur këtë mundësi disa herë në të kaluarën.

Nëntorin e kaluar, në 30-vjetorin e Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe, Shtetet e Bashkuara ritheksuan mbështetjen e tyre për sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnje dhe Hercegovinës, duke thënë se mbeten fuqimisht të përkushtuara për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në gjithë Ballkanin Perëndimor.

**Kush lobon për një Republikë Sërpska të pavarur?**

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, Qeveria e Republikës Sërpska ka angazhuar gjithsej 15 kompani amerikane lobimi dhe juridike, përfshirë edhe zyrën e saj përfaqësuese në SHBA, të regjistruar për të kryer aktivitete lobuese.

Deri në fund të vitit 2025, këtyre kompanive u janë paguar të paktën 8.3 milionë dollarë, sipas bazës publike FARA (Akti i Regjistrimit të Agjentëve të Huaj) të Departamentit amerikan të Drejtësisë.
Të gjitha kompanitë e angazhuara për lobim ose shërbime juridike kanë lidhje me qarqe politike republikane në Uashington.
Në qendër të vëmendjes është kontrata më e fundit, e nënshkruar më 6 shtator 2025 me kompaninë Dickens & Madson, në vlerë prej katër milionë dollarësh.
Në këtë kontratë thuhet shprehimisht se "pavarësia e Republikës Sërpska nga Bosnje dhe Hercegovina është qëllimi ynë përfundimtar".
Lobimi për pavarësi nuk ndalohet nga ligjet amerikane dhe lobistë mund të angazhojë kushdo, përveç personave ose subjekteve që janë nën sanksione.
Kushti i vetëm është që aktiviteti të regjistrohet në përputhje me Ligjin për Regjistrimin e Agjentëve të Huaj, i miratuar në vitin 1938.

Ky ligj kërkon që individët dhe organizatat që veprojnë në emër të qeverive, partive politike ose subjekteve të huaja, t'i bëjnë publike marrëdhëniet dhe aktivitetet e tyre.
Kompania Dickens & Madson u themelua nga Ari Ben-Menashe, një biznesmen izraelito-kanadez, i cili thotë se ka qenë ish-oficer i inteligjencës ushtarake izraelite.
Në vitin 2002, Ben-Menashe u mor në pyetje në Zimbabve në lidhje me akuza për një komplot të dyshuar për "eliminimin" e liderit të atëhershëm autoritar, Robert Mugabe.

Akuzat mbështeteshin në incizime të përgjimeve të takimeve të Ben-Menashes me liderin opozitar, Morgan Tsvangirai, i cili më vonë u shpall i pafajshëm.
Në vitin 2019, ai loboi për Këshillin Ushtarak Kalimtar të Sudanit, i cili mori pushtetin pas grushtshtetit që rrëzoi diktatorin shumëvjeçar, Omar al-Bashir.
Dy vjet më vonë, ai loboi edhe për juntën ushtarake të Mianmarit, pasi ushtria mori pushtetin dhe arrestoi lideren civile, Aung San Suu Kyi.
Ben-Menashe ka marrë, gjithashtu, një pjesë të fondeve nga financues të panjohur nga Rusia për të lobuar në favor të Sadyr Japarovit, i cili në atë kohë ushtronte detyrën e presidentit të Kirgizisë.

**A e shkel Kushtetutën e Bosnje dhe Hercegovinës lobimi për pavarësinë e Republikës Sërpska?**

Njëmbëdhjetë deputetë nga Federata e Bosnje dhe Hercegovinës dorëzuan në shkurt të vitit 2026 një kallëzim penal kundër Mlladen Fillipoviqit, nënshkruesit zyrtar të kontratës me kompaninë Dickens & Madson.
Fillipoviq drejton Zyrën Përfaqësuese të Republikës Sërpska në Austri, përmes së cilës u financua kontrata e lobimit.

**Ata e akuzuan atë për "sulm ndaj rendit kushtetues dhe cenim të integritetit territorial të Bosnje dhe Hercegovinës"**

Megjithatë, Prokuroria e Bosnje dhe Hercegovinës e hodhi poshtë kallëzimin, duke thënë se kjo vepër penale nënkupton "përdorimin e forcës, kërcënimeve ose veprimeve të tjera të kundërligjshme, të drejtuara ndaj ndryshimit me dhunë të rendit kushtetues ose integritetit territorial të shtetit".
"Paratë e buxhetit, në financimin e të cilit kontribuojnë të gjithë qytetarët dhe bizneset në Republikën Sërpska, por edhe në të gjithë Bosnje dhe Hercegovinën, po shpenzohen për lobim të paligjshëm dhe antikushtetues kundër shtetit të Bosnje dhe Hercegovinës", thotë për Radion Evropa e Lirë Denis Zvizdiq, një nga nënshkruesit e kallëzimit penal.
Ai i është drejtuar edhe Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës, e cila ende nuk ka marrë qëndrim për këtë çështje
Zvizdiq kërkon që Gjykata Kushtetuese të ndalojë përdorimin e mjeteve buxhetore nga të gjitha nivelet e pushtetit për lobim në mbështetje të objektivave që, sipas tij, bien ndesh me Kushtetutën, ligjet dhe vendimet e institucioneve të Bosnje dhe Hercegovinës.

Megjithatë, një vendim i mëhershëm i Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës, i vitit 2008, përcaktoi se secila nga 13 qeveritë në vend – ajo shtetërore, dy qeveritë e entiteteve dhe dhjetë qeveritë kantonale – ka të drejtë të angazhojë kompani lobuese.
Kjo e drejtë, sipas vendimit, i takon edhe Qeverisë së Republikës Sërpska.
Ky vendim u mor pasi ish-anëtari i Presidencës së Bosnje dhe Hercegovinës, Haris Sillajxhiq, kërkoi shfuqizimin e kontratës së parë të Republikës Sërpska me një kompani lobimi në SHBA, duke argumentuar se politika e jashtme është kompetencë ekskluzive e shtetit dhe jo e entiteteve.
Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë këtë argument, duke konstatuar se aktivitetet e Republikës Sërpska kishin për qëllim lobimin jashtë vendit për promovimin e interesave të saj si entitet dhe se ato nuk përbëjnë ushtrim të kompetencave ekskluzive të Bosnje dhe Hercegovinës në fushën e politikës së jashtme apo tregtisë së jashtme.

**Kë paguan Republika Sërpska për të lobuar?**

Sipas kontratave të nënshkruara gjatë dhjetë vjetëve të fundit, pas vendosjes së sanksioneve të para amerikane ndaj Millorad Dodikut në vitin 2017, Republika Sërpska ka shpenzuar të paktën 8.3 milionë dollarë për kompani lobimi në Shtetet e Bashkuara.

Shuma reale është edhe më e lartë, pasi vlera e disa kontratave është e censuruar në dokumentet publike.
Në regjistrimet sipas ligjit FARA, janë mbuluar honorarët mujorë të kompanisë Zell & Associates International Advocates, e themeluar posaçërisht për lobimin në emër të Republikës Sërpska nga avokati izraelito-amerikan, Marc Zell.
Ai është kryetar i degës së Partisë Republikane amerikane në Izrael dhe konsiderohet i afërt me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu.
Nga pjesët e dukshme të kontratës shihet se Zell do të merrte 500 mijë dollarë menjëherë pas nënshkrimit të saj – shumë që përfaqësonte 50 për qind të vlerës totale të kontratës.
E censuruar është edhe kontrata me kompaninë RRB Strategies, të drejtuar nga ish-guvernatori i Illinoisit, Rod Blagojevich, i cili ka vizituar disa herë Banja Llukën.
Blagojevich ishte dënuar për përpjekje për të "shitur" vendin vakant në Senatin amerikan, të mbetur pas zgjedhjes së Barack Obamës president i SHBA-së, si dhe për raste të tjera të korrupsionit politik dhe zhvatjes.
Presidenti amerikan, Donald Trump, ia shkurtoi dënimin me burg në vitin 2020, ndërsa në vitin 2025 e fali plotësisht, duke thënë se Blagojevich kishte qenë viktimë e një ndjekjeje të padrejtë dhe një dënimi tepër të ashpër.
Prindërit e tij ishin emigrantë serbë dhe ai ka folur shpesh për lidhjet me Serbinë, duke marrë pjesë edhe në aktivitete të diasporës serbe.
Në mesin e kompanive të angazhuara veçohet edhe CRB Global, e cila gjatë vitit 2026 përfaqëson njëkohësisht Qeverinë e Serbisë dhe Ministrinë për Integrime Evropiane dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar të Republikës Sërpska.

Dokumentet e regjistruara sipas FARA-s tregojnë se përfaqësues të CRB Global kanë zhvilluar të paktën dy takime me Bankën Amerikane të Eksportit dhe Importit (EXIM Bank), ku është diskutuar për sanksionet ndaj Qeverisë së Serbisë, pa u bërë publike detaje të tjera.
Për shërbimet e kësaj kompanie, Serbia paguan 10 mijë dollarë në muaj, ndërsa Republika Sërpska paguan 100 mijë dollarë në muaj.

**Heqja e sanksioneve dhe mbyllja e OHR-së**

Megjithëse kontratat ndryshojnë në përmbajtje, objektivat politike që synojnë, janë pothuajse të njëjta.

Një ndër prioritetet kryesore është heqja e sanksioneve amerikane ndaj Millorad Dodikut, bashkëpunëtorëve të tij, anëtarëve të familjes dhe personave e kompanive të lidhura me ta.
Shtetet e Bashkuara hoqën shumicën e këtyre sanksioneve në tetor të vitit 2025.
Megjithatë, Ambasada amerikane njoftoi në maj të vitit 2026 se "vazhdon të monitorojë sjelljen e të gjithë aktorëve dhe partive, përfshirë ish-presidentin Dodik, dhe ruan të drejtën të vendosë sanksione ndaj individëve kur kjo të jetë e nevojshme".
Kontratat e lobimit përfshijnë edhe qëllime të tjera, si: mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (OHR); vënien në pikëpyetje të legjitimitetit të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar, Christian Schmidt; promovimin e qëndrimeve të Republikës Sërpska për zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe, e cila i dha fund luftës në fund të vitit 1995, si dhe rishpërndarjen e kompetencave ndërmjet shtetit të Bosnje dhe Hercegovinës dhe entiteteve.
Schmidt dha dorëheqje në maj të këtij viti, ndërsa vendet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara ende po përpiqen të bien dakord për emërimin e pasardhësit të tij.

OHR-ja mbikëqyr zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit, ndërsa përfaqësuesi i lartë gëzon të ashtuquajturat kompetenca të Bonit, të cilat i mundësojnë të ndryshojë ligje dhe të shkarkojë zyrtarë publikë.




Pikërisht për moszbatimin e vendimeve të OHR-së, Millorad Dodik u dënua nga Gjykata e Bosnje dhe Hercegovinës dhe iu ndalua ushtrimi i funksioneve publike.
Disa prej kontratave të lobimit parashohin edhe organizimin e takimeve të zyrtarëve të Republikës Sërpska me zyrtarë amerikanë, ofrimin e këshillimit politik, zhvillimin e fushatave mediatike – veçanërisht në rrjetet sociale – ku përfshihen edhe ish-zyrtarë të Departamentit amerikan të Shtetit, si dhe mbështetje për krijimin e kontakteve dhe komunikimin me Shtëpinë e Bardhë, Kongresin dhe Departamentin e Shtetit.

Zyrtarë të Republikës Sërpska, të cilët deri vonë ishin nën sanksionet amerikane, përfshirë edhe Millorad Dodikun, kanë vizituar disa herë Shtetet e Bashkuara.
Më 7 prill, Donald Trump Jr., djali i madh i presidentit amerikan, Donald Trump, qëndroi në Banja Llukë.

Kontratat e Republikës Sërpska me kompanitë lobuese nuk përcaktojnë afate kohore për arritjen e objektivave politike.
Në to, kompanitë angazhohen të vazhdojnë promovimin e interesave të Republikës Sërpska pranë institucioneve amerikane.

**Institucionet shtetërore aktualisht pa lobistë**

Në regjistrimet publike sipas ligjit FARA nuk figurojnë kontrata aktive lobimi për Këshillin e Ministrave, Presidencën, Asamblenë Parlamentare të Bosnje dhe Hercegovinës, Qeverinë e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës apo për ndonjë zyrtar individual.

Politologu boshnjako-amerikan, Jasmin Mujanoviq, thotë se Republika Sërpska ka një strukturë institucionale më të thjeshtë, gjë që ua lehtëson partive në pushtet – të cilat qeverisin prej më shumë se dy dekadash – mobilizimin dhe financimin e rrjeteve lobuese.

"Republika Sërpska ka një aparat institucional më të centralizuar, gjë që i jep pushtetit më shumë hapësirë për të organizuar lobim në arenën ndërkombëtare", vlerëson Mujanoviq për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, "nëse te forcat politike në Sarajevë, që e konsiderojnë veten shtetformuese, do të ekzistonte vullneti politik, ka një sërë modelesh për të lobuar në emër të Bosnje dhe Hercegovinës".

Por, ai shton se një vullnet i tillë aktualisht mungon.
"Ndoshta këta aktorë politikë do të evoluojnë në muajt dhe vitet e ardhshme, por kam frikë se kjo mund edhe të mos ndodhë", thotë Mujanoviq.

Një përjashtim është Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnje dhe Hercegovinës, e drejtuar nga politikani i Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, Ellmedin Konakoviq, e cila ka nënshkruar një marrëveshje njëvjeçare me organizatën Aleanca Boshnjake-Amerikane për ofrimin e shërbimeve të lobimit, por pa kompensim financiar.

Përmes kësaj organizate, në prill të vitit 2025 u lidh një kontratë me kompaninë lobuese, Continental Strategy, për përfaqësimin e interesave të Bosnje dhe Hercegovinës para vendimmarrësve amerikanë

**Megjithatë, kontrata u ndërpre pesë muaj më vonë.**

Ndërkohë, në janar të vitit 2026, Republika Sërpska nënshkroi një kontratë njëvjeçare me të njëjtën kompani, Continental Strategy, në vlerë prej 420 mijë dollarësh, për lobim dhe këshillim në marrëdhëniet me administratën amerikane lidhur me çështjet politike, ekonomike dhe të sigurisë.

**(Radio Evropa e Lirë)**



190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

## Ne mund t'ju ndihmojmë

- Asylum & Immigration
- New Point Based System
- Settlement Applications (ILR)
- European Law
- Nationality&Travel Document
- Human Rights Applications
- High/Court of Appeals
- Over Stayers
- Work Premits
- Visa Extensions
- Judicial Reviews
- Tribunal Appeals



Konsultimet falas

07774222062

07878335000

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666



